

Zakon: Udhërrëfytesi

Fjala e hyrjes

Pas përgatitjeve të gjata, insistimit këmbëngulës të organizatave joqeveritare, të institucioneve mediale dhe të pjesës së mediave, dialogut midis shoqërisë civile e institucioneve të shtetit (Qeverisë dhe Kuvendit Popullor), vendosjes alternative në vazhdimësi, ndërprerjes dhe vazhdimit gjatë katër vjetëve, Serbia më në fund është bërë me Ligjin mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike. Ligji është miratuar dhe ka hyrë në fuqi më 13 nëntor të vitit 2004. Ndërkohë, Kuvendi Popullor e ka emëruar, në dhjetor vitit 2004, Komisararin për informata me rëndësi publike, por sot e kësaj dite – gati pesë muaj pas emërimit të tij - nuk ka siguruar kushte materiale e teknike që ky institucion i ri të nisë me kapacitet të plotë dhe të fillojë t’i ushtrojë kompetencat e veta në favor të zhvillimit të demokracisë dhe të qeverisjes së mirë në vend dhe në interes të qytetarëve të tij, që janë bartës të drejtave për qasje të lirë informatave me rëndësi publike.

Instituti i qasjes së lirë informatave në disponim të pushtetit publik, ndonse relativisht vonë dhe “mezi” ka hyrë në sistemin juridik të Serbisë, nuk është kurrfarë dukurie. Ideja e transparencës së punës së organeve të pushtetit nis nga shekulli XVIII, dhe për herë të parë është përligjuar në Suedi, më 1766, kur qytetarëve u është njohur përshtatshmëria e dokumentave dhe të dhënave në disponim të pushtetit administrativ (Tryckfrihetsförordning nga viti 1766). Gjithashtu edhe deklarata mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut e të Qytetarit nga viti 1789, e përmend këtë të drejtë. Megjithatë, ajo del në plan të parë gjatë tri dekadave të fundit të shekullit të njëzet, me ekspansionin dhe përfaqimin universal të konceptit të të “drejtave të njeriut” nga njëra anë, dhe konceptit të “menaxhimit të mirë” dhe parimit të transparencës në punën e organeve të shtetit, në anën tjetër. Sot, mbi 30 vende ua garantojnë me kushtetutë këtë të drejtë qytetarëve të vet. Përpos kësaj, mbi 50 vende e kanë rregulluar me ligj qasjen e lirë informatave me rëndësi publike në disponim të organeve të shtetit, ndërsa në mbi 30 vende ligjet e tilla janë në procedurën e përgatitjes ose të miratimit. Përpos shtetit, me parimin e transparencës në punën e vet dhe përshtatshmërinë e informatave, kanë filluar të udhëhiqen edhe organizatat ndërkombëtare. Në këtë pikëpamje është me rëndësi të përmendet shembulli i Bashkimit Evropian, kontrata themeluese e të cilit kategorikisht flet për përshtatshmërinë e informatave në disponim të Paralemntit, Komisionit dhe të Këshillit të Ministrave, kurse Karta mbi të Drejtat Themelore të BE, u garanton qytetarëve të BE qasje të lirë këtyre informatave.

E drejta për qasje të lirë informatave në disponim të pushtetit publik për herë të parë qytetarëve të Serbisë dhe Malit të Zi u është bërë e njohur me “Kartën e vogël”, respektivisht me Kartën mbi të Drejtat e Njeriut e të Minoriteteve dhe Liritë Qytetare.

Pse ka rëndësi realizimi i të drejtës për qasje të lirë informatave dhe krijimi i kushteve të plota për realizimin e saj efektiv dhe efikas?

Qasja e lirë informatave me rëndësi publike është kusht për gëzimin cilësor dhe efikas të të drejtave dhe lirive të tjera të njeriut (liria e mendimit, e drejta për informim, e drejta e zgjedhjes, etj), dhe është instrument i pazëvendësueshëm për ushtrimin e kontrollit mbi punën e organit të shtetit.

Kjo e drejtë ua hap rrugën qytetarëve që pa ndërmjetësues, realisht dhe me përgjegjësi të marrin pjesë në ushtrimin e punëve publike dhe në procesin e marrjes së vendimeve, si dhe të ndikojnë në përmbajtjen e tyre dhe zbatimin efikas.

Garantimi i kësaj të drejte dhe sigurimi i kushteve për realizimin e saj është instrument i nevojshëm që “parimi i qeverisjes” në punën e organeve të shtetit dhe i bartësve të kompetencave publike, të zëvendësohet me parimin e “qeverisjes së mirë”, dhe me këtë qytetari nga objekti të shndërrohet në subjekt të procesit politik, i cili në mënyrë të informuar dhe përgjegjëse, merr pjesë në punët publike dhe e bënë kontrollin mbi punën e tyre që ua ka besuar ushtrimin e pushtetit. Në këtë mënyrë njëkohësisht forcohet edhe parimi i përgjegjësisë në punën e të gjithë bartësve të pushtetit, dhe krijohen kushte për zhvillimin më të shpejtë të demokracisë, ndërtimin dhe stabilitetin e institucioneve të sistemit demokratik, por edhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Nxjerrja dhe zbatimi i plotë i Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike është me rëndësi të jashtëzakonshme të paktën edhe për dy arsye:

Njëra arsye është lufta efikase kundër korrupsionit. Me nxjerrjen e këtij Ligji janë krijuar kushtet minimale dhe të nevojshme për pengimin e shtrirjes dhe çrrënjësjes së formave ekzistuese të korrupsionit, sepse me hyrjen e tij në fuqi është kompletuar seti i ligjeve antikorrupsion, të cilin e përbëjnë: Ligji mbi pengimin e konfliktit të interesit; Ligji mbi furnizimet publike, Ligji mbi qasjen e lirë informatave me interes publik, dhe Ligji mbi financimin e partive politike. Nga vetë nxjerrja dhe futja e ligjeve në sistemin juridik, nuk mund të priten kurrfarë rezultatesh spektakulare. Duke krijuar kushte për aplikimin e tyre të plotë dhe vënien e plotë në jetë - pa ngurrim, kalkulim dhe luhate - mund të nxirren rezultate të pritura dhe të projektuara. Zbatimi i plotë dhe shfytëzimi i mundësive që ofrojnë këto ligje, varet në masë të madhe edhe nga vetë qytetarët. Ky pohim sidomos ka të bëjë me Ligjin mbi qasjen e lirë informatave. Atë në praktikë mund ta aktivizojnë, verifikojnë dhe testojnë para se gjithash qytetarët - individët dhe shoqatat e tyre, natyrisht krahas aktorëve të tjerë, siç janë mediat, personat e interesuar juridikë, e tjerë.

Aryseja tjetër është pengimi i përsëritjes së të kaluarës ku edhe sot gjendemi të ngujuar me një këmbë, të paafte ose pa mundësi që me atë të ballafaqohemi deri në fund, dhe e cila është e mbushur me historinë e shkëlqes masive të drejtave të njeriut, me krime, dosje të fshehta dhe me grumbullimin e fshehtë të të dhënave në bazë të vendimeve të marra sekrete të bartësve të autorizimeve publike. Transparenca edhe përgjegjësia në punën e organeve të shtetit dhe ekspozimi i kontrollit të ushtrimit të autorizimeve publike do ta reduktojnë në minimum rrezikun e përsëritjes së të kaluarës së frustruar e cila edhe sot nuk po mundëson që Serbia, në interes të qytetarëve të vet, të kacafytet pa rezervë me problemet ekzistuese dhe me sfidat e zhvillimit të ardhshëm.

Ky udhërrëfyes është ndërtuar në mënyrë që qytetarëve dhe mediave t’u ndihmojë që në masë të plotë ta shfytëzojnë mundësinë që u ofrohet dhe që, duke u mbështetur në këtë ligj, të kontribuojnë që ata të cilëve u është besuar pushteti publik, kompetencat e veta t’i ushtrtojnë me përgjegjësi dhe në përputhje me objektivat për të cilat u janë besuar kompetencat. Udhërrëfyesi duhet të shërbëjë edhe në dobi të organeve dhe organizatave që ushtrtojnë kompetenca publike dhe t’u ndihmojë atyre që procedurën e punës së vet ta ndërtojnë dhe harmonizojnë me kërkesat e këtij Ligji, dhe me arsyet dhe objektivat për të cilat ai është nxjerrë.

Nxjerrja e Ligjit mbi qasjen e lirë informatave i ka hapur edhe dy çështje, të cilat kërkojnë shqyrtim urgjent dhe rregullim përkatës.

Njëra është çështja e mbrojtjes së të dhënave personale që të mund të vendoset ekuilibri midis të drejtave të qytetarit për “të mësuar”, respektivisht që të ketë qasje informatave, dhe të drejtën e tij për privatësi. Pjesërisht, kjo çështje do të zgjidhet me legjislativ përkatës. Mirëpo, në masë të mirë vënia e ekuilibrit midis këtyre dy të drejtave varet edhe nga përkufizimi, me anë të praktikës, i standardeve të “interesit sundues”, të cilit i referohet Ligji mbi qasjen e lirë informatave. Puna dhe përgjegjësia e veçantë në ndërtimin e këtyre standardeve i takon Komisarit për informata publike.

Çështja tjetër ka të bëjë me klasifikimin e të dhënave dhe dokumentave në disponim të pushteteve publike. Ligji mbi qasjen e lirë informatave kërkon doemos legjislativ të ri dhe standarde të reja me të cilat do të zgjidhet se cilat dokumenta dhe të dhëna mund dhe duhet të shënohen si fshetësi, dhe me këtë të përshtatshme, për opinionin e gjerë. Rregullimi i kësaj çështjeje nënkupton kërkimin dhe vënien e ekuilibrit të ri midis dy koncepteve që gjenden në zhvillimin dhe ripërkufizimin e parreshtur midis konceptit të drejtave të njeriut dhe konceptit të rendit publik, si dhe shkëputjes me “kulturën e sekretit” të kultivuar kohë të gjatë në punën e shtetit.

Dr Jadranka Jelinçiq,

Drejtoreshë ekzekutive e Fondit për Shoqëri të Hapur

L i g j i

Udhërrëfyese i Ligjit mbi qasjen e lirë informatave

»Secili që kërkon ka të drejtë të mësojë çdo informatë në disponim të pushtetit, përpos në rastet në të cilat Ligji e ka caktuar ndryshe. Në qoftë se pushteti kërkuesit pa bazë ia kufizon informatën, prokurori mund t'i drejtohet Komisarit për informata me rëndësi publike dhe në mënyrë tjetër të parashikuar me Ligj, që ta realizojë të drejtën e vet«

E pse është nxjerrë Ligji? - “Informata është oksigjen i demokracisë”

Janë katër arsye kryesore për nxjerrjen e këtij ligji:

- Shoqëritë bashkëkohore demokratike mbështeten në idenë se informata është oksigjen për demokracinë dhe se opinioni ka interes të arsyeshëm të dijë për punët shtetërore. Qytetari mund ta kontrollojë me efikasitet organin e shtetit vetëm në qoftë se i ka të përshtatshme informatat që i disponojnë organet e shtetit. Qasja e lirë informatave të cilat i disponojnë organet e shtetit mundëson që qytetarët të jenë më mirë të informuar, kurse nëpunësit e shtetit më përgjegjës, gjë që e pakson rrezikun nga keqpërdorimi i fuqisë dhe siguron respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- Gazetarët dhe gazetatat publike në shoqërinë demokratike, si sy dhe vesh të opinionit, kanë një rol të veçantë të kontrollorit të punës së organeve të shtetit. Rregullat mbi përshtatjen e informatave publike u sigurojnë atyre kushte për grumbullimin efikas të të dhënave për punën e organeve të shtetit;
- Shoqëritë përhapimtare demokratike dallohen, pos tjerash, edhe sipas asaj nëse kanë miratuar ligj mbi qasjen e lirë informatave, dhe nëse atë e zbatojnë me efikasitet. Pasi që tash edhe ne kemi Ligj, u mbetet të gjithëve e veçmas gazetarëve që, duke kërkuar qasje informatave, ta fillojnë pushtimin e demokracisë atje ku rezistenca tradicionalisht është më e fuqishme – në burokracinë shtetërore e cila informatat mbi punën e vet i fsheh nga opinioni;

- Me miratimin e këtij ligji, deputetët e Kuvendit Popullor e kanë përmbushur njërin nga kushtet për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Këshilli i Evropës e ka nxjerrë, në shkurt të vitit 2002, Rekomandimin për shtetet anëtare mbi qasjen dokumentave publike dhe me këtë i ka ftuar që me dispozitat e veta ta mbrojnë interesin e individit që me efikasitet ta kontrollojë punën e organeve të shtetit. Ligji ynë në masën më të madhe përputhet me standardet juridike nga Rekomandimi i Këshillit të Evropës. Mbetet që edhe në jetë të vërtetohet se sa është i vullnetshëm shteti për t'i përmbushur detyrimet e veta ligjore dhe ashtu, jo vetëm me fjalë, t'i afrohet rrethit të vendeve evropiane të demokracisë së zhvilluar. Realizimit të këtij qëllimi duhet t'i shërbëjë edhe ky udhërrefyes.

II. Rregullat themelore mbi qasjen informatave

1. Informata me rëndësi publike

Çdo informatë për të cilën opinioni ka interes ta mësojë, e që e disponon organi i pushtetit publik, është informatë me rëndësi publike. Është krejt e njëjtë nëse informata gjendet në dokument i cili është krijuar në punën e organit të pushtetit publik ose lidhur me punën e tij, sikur që nuk është qenësore as nëse burim i informatës është vetë organi i pushtetit publik, apo dikush tjetër. S'është i qenësishëm as bartësi i informatës, do me thënë, nëse informata është në dokumentin e letrës, filmit, fotografisë, audio-shiritit, a është në formë elektronike apo në ndonjë medium tjetër. Më në fund, janë të parëndësishme edhe cilësitë e tjera të informatës, për shembull, kur është krijuar dokumenti, si e ka siguruar organi i pushtetit publik informatën e ngjashëm (neni 2).

Shembulli 1: Sa është shuma e shpenzimeve të udhëtimit të Presidentit të Rrepublicës gjatë vitit 2004? Sa është pjesa e shpenzimeve që është mbuluar nga buxheti i Republikës së Serbisë, e kush i ka bartur shpenzimet tjera?

*Shembulli 2: Nuk është me rëndësi kur është krijuar informata
Dikur në Slloveni ka ndodhur sa vijon: prokurori ia ka paraqitur një agjencie të shtetit kërkesën për shikimin e procesverbalit nga mbledhja, kurse agjencia e ka refuzuar kërkesën duke iu referuar faktit se mbledhja është mbajtur para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave. Komisari i atjeshëm ka vendosur se duhet të mundësohet shikimi i atij procesverbali. Zhvillim të ngjashëm të situatës duhet pritur edhe në Serbi – nuk është me rëndësi kur është krijuar dokumenti, është qenësore vetëm se atë, në momentin e zgjidhjes sipas kërkesës, organi i pushtetit publik vërtet edhe e disponon.*

Pra, informatën me rëndësi publike do ta njohim me sukses vetëm në bazë të dy elementeve:

- a) se fjala është për informatën që e disponon organi i pushtetit publik; dhe**
- b) se fjala është për informatën për të cilën opinioni ka interes të arsyeshëm ta dijë.**

Për të dy këto elemente në tekstin e mëtejshëm do të bëhet fjalë në veçanti.

2. Organi i pushtetit publik

Organet e pushtetit publik janë:

- Të gjitha organët e shtetit, për shembull, Kuvendi Popullor, Presidenti i Republikës, Qeveria, ministritë, administrata, entet, agjencitë e trupat e tjera, gjykatat përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, Prokuroria, Avokati Publik;
- trupat e pavarur të formuar me ligje, sikurse janë Këshilli i Radioshpërndarjes, Komisioni për letra me vlerë, Komisari për qasje informatave me rëndësi publike, Ombudspersoni dhe organët e ngjashme të autonomive territoriale, të qyteteve e komunave, siç janë Kuvendi i Krahinës Autonome të Vojvodinës, kuvendet e qytetit e të komunave, këshillat e pakicave kombëtare etj.;
- oragnizatat të cilave u është besuar ushtrimi i pushtetit të caktuar, respektivisht i kompetencave publike, bie fjala ndërmarrjet për elektrodistribucion, telekomunikacione, shërbime komunale – ujësjellësi, kanalizimi, hapësirat e gjelbëra, hapësira e parkingut publik, trafiku i qytetit, por edhe llojet e tjera të organizatave, siç janë odat e avokatëve apo inxhinierëve, Biblioteka Popullore, Instituti për Siguri, e ngjashëm; dhe
- personat e tjerë juridikë që i ka themeluar, ose punën e të cilave e financon në tërësi apo në pjesën më të madhe ndonjëri nga organet e përmendura të pushtetit publik, sikurse janë: entet parashkollore, shkollat fillore e të mesme, institutet shkencore, fakultetet dhe universitetet, spitalet, klinikat, vendshërimet, qendrat e rehabilitimit, shtëpitë e azilit për pleq, teatrot, agjencitë për koncerte, shtëpitë e kulturës e ngjashëm.

Prandaj, informata me rëndësi publike është informatë që e disponon cilido organ i pushtetit publik (neni 3).

3. Interesi i arsyeshëm i opinionit për të ditur

Sipas Ligjit, interesi i arsyeshëm i opinionit për të ditur ekziston lidhur me të gjitha informatat që i disponon organi i pushtetit publik. Kërkuesi i informatës nuk duhet të dëshmojë se ka interes të dijë për ndonjë informatë të caktuar, e as të dëshmojë se ky interes i tij është i arsyeshëm. Organi i pushtetit publik nuk guxon të kërkojë nga kërkuesi që t'i cekë arsyet për paraqitjen e kërkesës (neni 15, al. 4).

Në qoftë se organi i pushtetit publik ia shkurton kërkuesit qasjen informatës së caktuar është i detyruar të dëshmojë se në rastin konkret është e arsyeshme ta bëjë këtë për shkak të mbrojtjes së interesit mbizotërues, si interesi i sigurisë së vendit apo privatësia e tjerëve. Si të konstatohet saktësisht nëse është fjala për rastin e kufizimit të arsyeshëm të qasjes informatave, do të sqarohet në kaptinën (III) në vijim, të Udhërrefyesit. Në këtë vend duhet cekur edhe rregullin për të ashtuquajturat informata të privileguara – organi i pushtetit publik kurrë nuk guxon ta kufizojë qasjen informatave që kanë të bëjnë me rrezikimin edhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve dhe të ambientit (neni 4). Lidhur me këto informata, organit nuk i lejohet të dëshmojë se opinionin nuk ka interes të arsyeshëm të dijë për to.

Shembulli 1: Një njeri para largimit nga Serbia, në vitet e 40-ta të shekullit të kaluar, e ka futur në dhe një qyp me dukat, në një luadh të Vozhdovacit. Sipas orientimeve nga ajo kohë e ka shënuar në hartë se ku gjendet thesari, dhe para vdekjes hartën ia ka dhënë nipit të vet. Nipi, shtetas i Kanadës, për herë të parë vjen në Serbi dhe e sheh se harta e gjyshit është e papërdorshme, sepse në vendin e orientimit të dikurshëm gjenden ndërtesa dhe lulishte. Megjithatë, duke mësuar për Ligjin mbi qasjen e lirë informatave nuk e humb shpresën dhe pas hulumtimeve nëpër arkiva i kërkon dhe i merr planet e ngastrave të tokave nga periudhat e ndryshme, në bazë të të cilave vëretetohet me saktësi se ku gjendet thesari. Lidhur me këtë rast askujt nuk i shpjegon se për çka po i nevojiten kopjet e atyre planeve të vjetra. I paguan vetëm shpenzimet e nevojshme për kopjimin e dokumentave që ka dashur t'i marrë me vete për ta gjetur thesarin.

Shembulli 2: Në stacionin transportues hekurudhor të Beogradit – Dorçoll, treni ka rrëshqitur nga binarët pas çkahit është derdhur materja me erë të keqe. Gazetarët u janë drejtuar pushtetarëve të qytetit dhe Minsitrisë për Mbrojtjen e Ambientit me kërkesë që pa shtyrje të përgjigjen në këto pyetje:

- *Për cilën materje është fjala?*
- *A është dhe në ç'masë është e rrezikshme për shëndetin e popullatës?*
- *Si duhet të sillet popullata përreth stacionit hekurudhor?*
- *Çka do të ndërmarrin organet e shtetit për eliminimin e pasojave të kësaj fatkeqësie?*

4. E drejta për qasje informatave

Janë katër të drejta themelore ligjore lidhur me qasjen informatave me rëndësi publike (neni.5):

- e drejta e kërkuesit që t'i kumtohet nëse organi i pushtetit publik e disponon informatën e caktuar, respektivisht a i është ajo e përshtatshme;
- e drejta e kërkuesit që informata me rëndësi publike t'i bëhet e përshtatshme, ashtu që do t'i mundësohet ta shikojë dokumentin që e përmban këtë informatë;
- e drejta e kërkuesit që me pagimin e kompensimit ta marrë kopjen e dokumentit që e përmban informatën e kërkuar; dhe
- e drejta e kërkuesit që kopja e dokumentit me pagimin e kompensimit t'i dërgohet në adresë me postë, faks, në mënyrë elektronike apo me ndonjë formë tjetër.

Për privilegjet lidhur me pagesën e kompensimit për punimin e kopjes së dokumentit do të bëhet fjalë në veçanti, në kaptinën IV të udhërrefyesit.

Kërkuesi e gëzon të drejtën e informatës së vërtetë dhe të plotë, kurse organi i pushtetit publik që e ka dhënë informatën e pavërtetë dhe të paplotë përgjigjet me kundërvajtje (neni 46, pika 4). Organi i pushtetit publik përgjigjet për dëmin e shkaktuar ashtu që pa bazë e ka kufizuar qasjen informatës së kërkuar.

Nëse informata e kërkuar veç është e përshtatshme opinionit, është e drejtë e kërkuesit që organi ta drejtojë atje ku ajo është publikuar.

Nëse dokumenti përmban pjesë për të cilat opinioni nuk ka interes të arsyeshëm të dijë, kërkuesi ka të drejtë që organi i pushtetit publik t'ia bëjë të përshtatshme pjesët e tjera të atij dokumenti.

Shembull: Ndërmarrësi ndërtimor i paraqet kërkesë Entit Republikan të Gjeodezisë për punimin e kopjes elektronike të filmimit të ngastrës së kadastrit G-126/28, nga Komuna Kadastrale Vračar, dhe kërkon që kopja t'i dërgohet me postë elektronike.

5. Kush ka të drejtën e qasjes informatave?

Secili, nën kushte të njëjta, ka të drejtën e qasjes informatave. Nuk është me rëndësi nëse kërkuesi i informatës është shtetas i vendit apo i huaj, e as ajo nëse ka vendqëndrim apo vendbanim në territorin e Republikës së Serbisë, a diku tjetër. Nuk është e lejueshme të diskrimohen kërkuesit e

informatave sipas cilësisë së tyre personale, sikurse është përkatësia kombëtare ose etnike, predikimi fetar, raca, gjinia, invaliditeti e ngjashëm.

Të drejtat e garantuara me ligj u takojnë edhe individëve edhe personave juridikë. Ligji garanton në veçanti trajtim të barabartë të të gjithë gazetarëve të mjeteve publike (ndalimi i diskriminimit). Organi i pushtetit publik është i obligueshëm që ta kompensojë dëmin e shkaktuar në qoftë se qasjen informatave ua ka mundësuar vetëm disa gazetarëve apo mjeteve publike, ose në qoftë se me këtë qasja informatave është mundësuar përpara se tjerëve (neni 7 e 44).

Shembulli 1: Prodhuesi i njohur rus i kontejnerëve kërkon nga shërbimi komunal i komunës së Vrshacit kopjen e dokumentacionit të tenderit lidhur me blerjen e kontejnerëve për higjienën e qytetit. Kjo kërkese nuk mund të refuzohet për shkak që kërkuesi nuk e ka cilësinë e ofertuesit në tender, e as që dhënja e kopjes së dokumentave mund të kushtëzohet me pagesën e shumës më të madhe nga ajo e cila i mbulon shpenzimet e domosdoshme të shumëzimit të tij.

Shembulli 2: Industria e Naftës e Serbisë (NIS), e merr kërkesën nga një gazetar që t'i dërgohen informatat mbi sasinë dhe prejardhjen e naftës së papërpunuar, të importaur gjatë vitit të kaluar. NIS mund ta njoftojë opinionin për informatat e kërkuara në konferencën për gazetarë, por për këtë nuk është e obligueshme. Nëse këtë megjithatë nuk e bën, është e obligueshme që në kërkesën e gazetarit të përgjigjet në afatin e normuar. Mirëpo, nëqoftë se para dërgimit të përgjigjes ka mbërritur edhe ndonjë kërkese nga gazetarë tjerë që ka të bëjë me informatën e njejtë, NIS është e obligueshme që përgjigjen t'ua dërgojë njëkohësisht të gjithë gazetarëve që e kanë dërguar kërkesën dhe ashtu të sigurojë barazinë e tyre.

6. Komisari për qasje informatave publike – institucion i ri në sistemin juridik

Komisari është organ i shtetit i formuar me këtë ligj. Detyra e tij është që të kujdeset për realizimin e papengueshëm të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike, e sidomos:

- të vendosë për ankesat ndaj vendimeve të organit të pushtetit publik;
- të hartojë dhe botojë doracakë me udhëzime praktike për realizimin e të drejtave të parashikuara me ligj, dhe
- t'ia paraqesë Kuvendit Popullor raportet e rregullta për atë se si organet e pushtetit po e zbatojnë ligjin.

Komisari e ka shërbimin e vet profesional. Në ushtrimin e punëve të veta, Komisarit është i pavarur dhe i mëvetshëm, që nënkupton se nuk guxon të kërkojë ose marrë urdhëra dhe udhëzime për punën e vet nga organet e shtetit apo personat e tjerë.

III. Kur është e kufizuar apo e përjashtuar qasja informatave me rëndësi publike?

1. Rregulla themelore: testi trepjesorë

Kërkuesi i informatës nuk ka përherë të drejtën për secilën informatë që e disponon organi i pushtetit publik.

Organi i pushtetit publik është i detyruar që të mundësojë qasjen informatës së kërkuar nëse në rastin konkret janë plotësuar tri kushte (neni 8, al. 1):

1. nëse njëri nga interesat e numruara në Ligj i kundërvehet kërkesës së kërkuarit për të ditur;
2. nëse me qasjen informatës ky interes i kundërt do të shkilej seriozisht;
3. nëse nevoja e mbrojtjes së interesit të kundërt i mbikalon nevojat e mbrojtjes së interesit të kërkuarit për të ditur, duke e gjykuar të domosdoshme shkurtimin e qasjes, sipas kuteve të shoqërisë demokartike.

Shqyrtimi (testi) nëse organi i pushtetit publik e shkurton në harmoni me ligjin qasjen e kërkuar, për këtë shkak, ka tri pjesë: 1. a i shkurtohet qasja e kërkuar për mbrojtjen e ndonjërit nga interesat e numrura me Ligj (neni 9, 13 e 14) dhe, nëse vërtetohet se është ashtu; 2. a do të shkilej seriozisht ai interes në rastin konkret me mundësimin e qasjes së kërkuar; 3. dhe, a është sipas kuteve të shoqërisë demokartike e domosdoshme të shkurtohet qasja informatës..

Shembull: Të supozojmë se ekspertët e Ministrisë së Financave kanë përgaditur elaboratin për keqpërdorimet e disa formave të lehtësirave tatimore, e për shkak të lëshimeve në rregullativën ose të kapaciteteve jopërgjegjëse të kontrollit, dhe se ai elaborat duke qenë se është material pune, ka statusin e sekretit zyrtar. Gazetari i cili merret me çështjet ekonomike e përpunon temën e keqpërdorimeve të lehtësirave tatimore dhe drejton kërkesën për këto informata: A ka vërejtur Ministria, nga fillimi i zbatimit të lehtësirave të reje tatimore, ndonjë lloji të keqpërdorimit të lehtësuarve tatimore? Në cilat fusha janë më të shpeshta keqpërdorimet? Cilat janë përmasat dhe cilat janë shkaqet e këtyre keqpërdorimeve?

Përgjigjet në pyetjet nga kjo kërkesë gjenden të saktësuara në elaboratin i cili e ka statusin e sekretit zyrtar. Fshehtësia e elaboratit është caktuar sipas automatizmit për shkak se fjala është për materialin e punës, por vetëm ky fakt nuk do të thotë se sekreti duhet të ruhet me çdo çmim. Në rastin konkret, ekziston interesi shoqëror që dobësitë në rregullativën ose kapacitetet kontrolluese të mësohen, në mënyrë që të korrigjohen. Nga ana tjetër, publikimi i këtyre dobësive, para se të korrigjohen, mund të sjellë keqpërdorime edhe më të mëdha të lehtësirave tatimore (“shkelja serioze në rastin konkret”). Domethënë, arsye e mirë (“e domosdoshme në shoqërinë demokratike”) që sekretit edhe një kohë të ruhet mund të jetë përgatitje për masat ndërhyrëse, të cilat do ta eliminojnë problemin (të korrigjohet rregullativa ose të shtohet kontrolli), ndërsa gazetari mund të marrë përgjigje në këtë kuptim (me të cilin, dorën në zemër, me siguri nuk do të ishte i kënaqur).

Për çdo rast, pasi që të merren masat urgjente, ose kur të kalojë koha e arsyeshme për përgatitjen dhe miratimin e tyre, do të kishte shumë më pak arsytim të ruhet sekretit i informatave të cilat i përmban elaborati i përmendur, pavarësisht nga fakti nëse dokumenti dhe më tutje e bartë shenjën “sekrete”.

2. Cilët interesa janë numëruar në Ligj?

Ligji (në nenin 9, 13 dhe 14) i numëron të gjitha interesat që mund t'i kundërvehen interesit të kërkuarit për të ditur. Jashtë këtij rrethi të interesave, nuk ekziston asnjë tjetër për shkak të të cilit organi i pushtetit publik do të mund ta kufizonte qasjen informatës. Këto janë ineteresat në vijim:

* jeta, shëndeti, siguria ose ndonjë e mirë tjetër e ndonjë personi (neni.9, al.1, p.1);

* pengimi ose zbulimi i veprës penale, akuzimi për vepër penale, zhvillimi i procedurës parapenale respektivisht i procedurës gjyqësore, ekzekutimi i aktgjykimit ose zbatimi i dënimit, zhvillimi i ndonjë procedimi tjetër të rregulluar judirdikisht, sjellja fer dhe gjykimi i drejtë (neni 9, al.1, p.2);

- * mbrojtja e vendit, siguria kombëtare ose publike, marrëdhëniet ndërkombëtare (neni 9, al.1, p, 3);
- * aftësia e shtetit për t'i drejtuar proceset ekonomike në vend, realizimi i interesave të arsyeshme ekonomike (neni.9, al.1, p.4);
- * sekreti shtetëror, zyrtar, afarist apo tjetër (neni 9, al.1, p.5);
- * pengimi i keqpërdorimit të drejtës për qasje informatave (neni13);
- * e drejtat në privatësi, prestigj dhe ndonjë e drejte tjetër e personit për të cilin informata e kërkuar ka të bëjë personalisht (neni.14).

3. Çka është shkelja serioze në rastin konkret?

Nëse konstatohet se qasja e kërkuar informatës mund të kufizohet për mbrojtjen e ndonjërit nga interesat e numëruara, kjo ende nuk mjafton që të përfundohet se kufizimi ka qenë në përputhje me Ligjin. Nevojitet që edhe të konstatohet se në rastin konkret ai interes me qasjen informatës do të shkilej seriozisht. Kjo nënkupton se qasja e kërkuar:

- * e ka rrezikuar seriozisht jetën, shëndetin, sigurinë ose ndonjë të mirë tjetër të rëndësishme të ndonjë personi;
- * e ka rrezikuar seriozisht, e ka penguar ose e ka vështirësuar pengimin apo zbulimin e veprës penale, akuzimin për veprë penale, zhvillimin e procedurës parapenale, zhvillimin respektivisht procedurën gjyqësore, ekzekutimin e aktgjykimit ose zbatimin e dënimit, e cilës do të drejte tjetër të procedurës së rregulluar juridikisht, ose sjelljen fer dhe gjykimin e drejtë;
- * e ka rrezikuar seriozisht mbrojtjen e vendit, sigurinë kombëtare apo publike, marrëdhëniet ndërkombëtare;
- * e ka pakësuar qenësisht aftësinë e shtetit për t'i drejtuar proceset ekonomike në vend, ose realizimin e interesave të arsyeshme ekonomike;
- * ka shkatuar pasoja të rënda juridike apo tjera për interesat e mbrojtura me ligj që i, apo mbizotrojnë interesat për qasjen informatës e cila paraqet fshehtësinë shtetërore, zyrtare, afariste e tjetër;
- * paraqet keqpërdorimin serioz të së drejtës për qasje informatave;
- * e ka shkelur seriozisht të drejtën për privatsi, për prestigj dhe të drejtën tjetër të personit me cilin ka të bëjë personalisht informata e kërkuar

4. Domosdoshmëria në shoqërinë demokratike

Në shoqërinë demokratike nuk është e domosdoshme të shkutohet qasja e kërkuar:

- nëse me atë edhe ashtu nuk mund të mbrohen interesat e numëruara në Ligj, ose
- nëse mbrojtja e interesave mund të realizohet njëllojë në mënyrë tjetër, ose
- nëse me këtë shkurtohet qasja informatës në masën më të madhe se që mjafton për mbrojtjen e interesave të numëruara.

Në shumë raste në të cilat pushtetit jodemokratik nuk mund ta paramendojë që qytetarëve t'u jenë të përshatshme informatat, pushtetit demokratik nuk i duket e domosdoshme që t'ua shkurtojë qasjen. Organi i pushtetit publik ka detyrim që të udhëhiqet nga kutet e shoqërisë demokratike, duke vlerësuar nëse në rastin konkret qasja informatës do ta rrezikonte seriozisht ndonjërin nga interesat e numëruara me Ligj. Duke pasur parasysh natyrën e shoqërisë demokratike, organi i pushtetit publik do të mundësojë qasjen e kërkuar – kur përkundër rrezikimit serioz të ndonjërit nga interesat e numëruara këtë e kërkon sidomos interesi i arsyeshem publik, posaçërisht nëqoftë se informata ka të bëjë me shkeljen e ligjit nga ana e pushtetit, tejkalimin e kompetencave, ushtrimin e pandërgjegjshëm të punëve etj.

Shemuajt

Organi i pushtetit publik ua kufizon me bazë qasjen e kërkuar, bie fjala, këtyre informatave:

- * Cili është identiteti i ri i dëshmitarit të mbrojtur, Petar Petroviq dhe ku gjendet ai momentalisht?
- * Cilat procedime operative, ku dhe kur i ka ndërmarrë tani policia, dhe cilat planifikon t'i ndërmarrë me qëllim të kapjes së dy të arratisurve nga Burgu në Mitrovicën e Sremit?
- * Në cilat harqe kohore patrulla kufitare kalon midis pikës A dhe pikës B, në kufirin me Maqedoninë?
- * Transkripti i bisedimeve të presidentit të Republikës së Serbisë me presidentin e Republikës së Francës?
- * Sa janë rezervat strategjike të naftës në të cilat mund të llogaris Qeveria në krizën e ardhshme të naftës?
- * Kush është paraqitur tani më për pjesëmarrje në tender, nëse informata kërkohet para përfundimit të afatit për aplikim?
- * Kërkimi i numrit të madh të informatave, bie fjala, të dhënat mbi të gjitha rrogat e paguara ndonjëherë për secilin të punësuar të dikurshem në ministrinë përkatëse, ose kërkesa e pakuptueshme e përsëritur shpesh e informatës së njejtë, veç të marrë.
- * Të dhënat nga kartoni medicinal i pacientit, Mirko Mirkoviçit, i cili nuk është pajtuar që ato të dhëna të bëhen publike, nuk është bartës i funksionit publik për çka këto të dhëna do të ishin të rëndësishme, e as që me sjelljen e vet lidhur me jetën private është pjesë e shkasit për kërkimin e informatës.
- * Cilat njohuri i ka mësuar organi i pushtetit duke e ushtruar kontrollin financiar të afarizmit të ndërmarrjes private konkurrenente, ose të gjendjes së xhirollogarisë së ndonjë qytetari?
- * Para paraqitjes në shikim të kontratës të cilën kuvendi i qytetit e ka lidhur me këngëtarin e njohur për pjesëmarrjen e tij në koncertin e vitit të ri, të dhënat për adresën dhe numrin e llogarisë bankare në dokument do të jenë të papërshtatshme.

5. Kontesti për atë nëse kërkesa e qasjes është kufizuar në harmoni me Ligjin

Organi i pushtetit publik i cili e shkurton qasjen e kërkuar, është i obliguar të thotë se në rastin konkret nuk ekziston interesi i arsyeshem i kërkuesit për të ditur (neni 4). Me kërkesë të kërkuesit të informatës, Komisari dhe organi tjetër i mbrojtjes së të drejtës për qasjen e lirë informatave, do

të verifikohet me anë të testit trejtesorë nëse organi i pushtetit publik ka proceduar drejt. Për këtë procedim të drejtë më afër në vazhdim, në kaptinën IV.

IV Procedura për realizimin e të drejtave për qasjen e lirë informatave me rëndësi publike

1. Si inicohet procedura?

Procedura për realizimin e të drejtës për qasje të lirë informatave me rëndësi publike inicohet me paraqitjen e kërkesës personit zyrtar të pushtetit publik, i cili e disponon informatën. Në qoftë se personi zyrtar për procedimin e kërkesës nuk është caktuar, për procedim është kompetent udhëheqësi i organit të pushtetit (neni 38).

Kërkesa mund të paraqitet si në formën e shkruar ashtë edhe me gojë. Organi i pushtetit mund të normojë formularin për paraqitjen e kërkesës, por duhet ta shqyrtojë edhe kërkesën që nuk është bërë në atë formular. Kur informata kërkohet me gojë, kërkesa kumtohet në procesverbal të cilin e mban personi i autorizuar i organit të pushtetit publik për qasje informatave.

2. Çka përmban kërkesa?

Kërkuesi në kërkesë e cek:

- emrin e organit të pushtetit,
- emrin e mbimrin e vet, adresën, respektivisht selinë nëse kërkuesi është personi juridik,
- përshkrimin e informatës e cila kërkohet,
- dhe të dhënat e tjera që e lehtësojnë gjetjen e informatës.

Shembull: Gazetari i drejtohet Kuvendit Popullor duke kërkuar informatën mbi importimin e energjisë elektrike. Me kërkesë e rikujton personin e autorizuar të Kuvendit Popullor se informata e tillë mund të gjendet në materialet e grumbulluara për nevojat e Këshillit anketues të Kuvendit, i cili është marrë me këtë temë, gjatë vitit 2004.

Kërkuesi nga organi i pushtetit publik mund të kërkojë:

- njoftimin nëse e disponon informatën e kërkuar,
- që t'i mundësohet ta shikojë dokumentacionin i cili e përmban informatën e kërkuar,
- që t'ia japë kopjen e atij dokumenti,
- që t'ia dërgojë kopjen e dokumentit me postë ose në ndonjë formë tjetër.

Posaçërisht është me rëndësi të theksohet se kërkuesi nuk është i detyruar t'i përmend arsyet për paraqitjen e kërkesës.

3. Çka nëse kërkesa nuk është e plotë ose e parregullt?

Personi i autorizuar i organit të pushtetit është i obligueshëm ta mësojë kërkuesin si t'i eliminojë mangësitë në qoftë se kërkesa nuk është e plotë (nuk i përmban të gjitha të dhënat e domosdoshme), respektivisht është e parregullt (e pakuptueshme nga pikëpamja e asaj që kërkohet). Nëse kërkuesi nuk i eliminon mangësitë në afatin e duhur, kurse mangësitë janë të atilla sa që kërkesa nuk mund të procedohet, organi i pushtetit do të nxjerrë konkluzionin për refuzimin e kërkesës si të parregullt.

Shembull:

** Kërkuesi ia drejton kërkesën “qytetit të Nishit”, por nuk e cek organin të cilit i adresohet kërkesa (p.sh. kryebashkiaku, bashkia e qytetit ose kuvendi i qytetit)*

**Paraqitësi i kërkesës kërkon që përgjigjet t’i dërgohen me rrugë elektronike, por në kërkesë nuk e cek adresën elektronike.*

** Kërkuesi e ka shkruar jolexueshëm emrin dhe mbiemrin e vet.*

** Kërkuesi i dërgon kërkesën në memorandumin e organizatës, por e cek adresën e vet private përfundi nënshkrimin, ashtu që nuk mund të konkludohet nëse kërkesën po e dërgon në emër të vetin, apo në emër të organizatës.*

**Paraqitësi kërkon informata për atë sa veçon mjete organi i pushtetit për pagimin e faturave të telefonit, por pa e caktuar periudhën për të cilën ka të bëjë informata (për muajin e kaluar, vitin e kaluar, sa mjete janë planifikuar për vitin buxhetor në vijim, e tjera).*

4. Afati në të cilin organi i pushtetit duhet të procedojë sipas kërkesës së kërkuarit

Organi i pushtetit është i obligueshem pa shtyerje, e më së voni në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, të procedojë sipas kërkesës së kërkuarit. Kjo nënkupton se organi i pushtetit është i obligueshem që në këtë afat ta njoftojë kërkuarin nëse e disponon informatën, që t’ia mundësojë shikimin e dokumentit i cili e përmban informatën e kërkuar si dhe t’ia lëshojë, respektivisht t’ia dërgojë kopjen e atij dokumenti.

Në qoftë se organi i pushtetit nuk ka mundësi për shkaqe të arsyeshme, që në afatin prej 15 ditësh të procedojë sipas kërkesës së kërkuarit, është i obligueshem që për këtë ta njoftojë menjëherë dhe ta caktojë afatin tjetër në të cilin do të procedojë sipas kërkesës, e i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 40 ditë, nga pranimi i kërkesës.

Organi i pushtetit duhet patjetër të procedojë sipas kërkesës së kërkuarit në afatin prej 48 orësh, nga pranimi i kërkesës, nëse kërkesa ka të bëjë me informatën për:

- mbrojtjen e jetës dhe të lirisë së individit,
- rrezikimin ose mbrojtjen e shëndetit të popullatës,
- rrezikimin ose mbrojtjen e ambientit.

Kërkuesi mund t’i paraqet ankesë Komisarit nëse organi i pushtetit nuk përgjigjet në kërkesën e tij, në afatin e normuar.

Shembull: Kërkuesi i drejtohet entit parashkollor të komunës së vet me kërkesën që ta marrë kopjen e planeve të edukimit për fëmijët e moshës deri tre vjeç (p.sh. për shkak se ka përshtypje se edukatorët nuk po punojnë me fëmijën e tij në masën e duhur). Të themi se një dokument i tillë ekziston, se kërkuesi personalisht ia ka dorëzuar kërkesën personit të autorizuar të entit dhe se këtij personi i nevojiten disa minuta për ta gjetur dokumentin dhe për ta fotokopjuar. Është e evidente se një kërkesë e këtillë mund të kënaqet “pa shtyerje” dhe është obligim i personit të autorizuar edhe të bëjë ashtu.

Mirëpo, në qoftë se nëpunësi i entit parashkollor është i ngarkuar me punë tjera (me procedime sipas kërkesave tjera ose lidhur me detyrat e tjera të punës që gjithashtu i ushtron), është e mundshme që të mos merret me kërkesën e kërkuarit, por gjithsesi është i obligueshem që kopjen e dokumentit t’ia dërgojë në afatin prej 15 ditësh (me pagim të kompensimit).

Në qoftë se, megjithatë, kërkuesi ka kërkuar edhe shikimin e literaturës profesionale në bazë të së cilës janë ndërtuar planet e edukimit (dhe e cila, bie fjala, mund të identifikohet dhe gjendet në

bibliotekën dhe dokumentacionin e entit) personi i autorizuar, pas marrjes së kërkesës, këtë do ta kënaq pa shtyrje në masën në të cilën mundet (do t'ia përcjellë kopjet e planeve të edukimit) dhe do t'ia dërgojë kërkuarit njoftimin se shikimin e literaturës profesionale mund ta realizojë brenda 40 ditësh në lokalet e entit (duke e arsyetuar afatin me kohën që i nevojitet personit zyrtar që saktësisht ta vërtetojë se për cilën literaturë është fjala dhe ta përgatis që kërkuarit t'ia mundësojë ta shikojë).

5. Si vepron organi i pushtetit kur e mundëson qasjen informatave?

Organi i pushtetit e njofton me shkrim kërkuarin:

- se e disponon ose nuk e disponon informatën e kërkuar;
- se mund ta shikojë dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar në lokalet zyrtare të organit të pushtetit në kohën e caktuar dhe sipas mënyrës së caktuar, respektivisht
- se do t'ia lëshojë ose dërgojë kopjen e atij dokumenti, me shumën e shpenzimeve të nevojshme të kopjimit ose dërgimit.

Kur organi i pushtetit ia mundëson kërkuarit qasjen informatës, për këtë nuk do të lëshojë aktvendim të veçantë, por do të mbajë shenime zyrtare.

6. Si realizohet e drejta e shikimit?

Shikimi i dokumentit, i cili e përmban informatën e kërkuar bëhet me pajisje të nevojshme të cilën e disponon organi i pushtetit, përpos kur kërkuari i kërkesës shikimin e bën duke përdorur pajisjen e vet.

Kërkuari mund të kërkojë për shkaqe të arsyeshme që shikimin e dokumentit ta bëjë në ndonjë kohë tjetër nga koha që i është caktuar në njoftim.

Personit i cili nuk është në gjendje pa përcjellës ta bëjë shikimin e dokumentit, do t'ia mundësohet që këtë ta bëjë me ndihmën e përcjellësit.

Në qoftë se organi i pushtetit disponon dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar në gjuhën në të cilën është paraqitur kërkesa, ka për detyrë që kërkuarit t'ia vë në dispozicion dokumentin në gjuhën në të cilën edhe është paraqitur.

7. Si realizohet e drejta për kopjim?

Organi i pushtetit e lëshon kopjen e dokumentit e cila e përmban informatën e kërkuar në formën në të cilën është informata (fotokopje, audiokopje, videokopje, kopje digjitale e ngjashëm). Në qoftë se nuk ka mundësi teknike për të lëshuar kopjen e dokumentit në formën në të cilën informata gjendet, organi i pushtetit do ta punojë kopjen në formën tjetër, ose do ta njoftojë kërkuarin se mund ta punojë kopjen me përdorimin e pajisjes së vet.

Në qoftë se organi i pushtetit disponon dokumentin i cili e përmban informatën në gjuhën në të cilën është paraqitur kërkesa, ka për detyrë që kërkuarit t'ia lëshojë kopjen e dokumentit në gjuhën në të cilën edhe e ka paraqitur.

Shembull: Kërkuari i drejtohet Auto-Moto-Lidhjes me kërkesën që t'ia lëshohet fotokopja e posterit në kolor ku ftohen shoferët që të mos i shfrytëzojnë telefonat celular gjatë grahjes së makinave. Mirëpo, personi i autorizuar i Lidhjes konstaton se posteri është me dimensione jostandarde, dhe faktin se Lidhja nuk disponon aparat kopjativ në kolor, po vetëm në formën zi-bardhë. Prandaj, e njofton paraqitësin e kërkesës se mund t'ia lëshohet vetëm kopja zi-bardhë, e cila me këtë rast do të jetë 20% më e vogël se origjinali.

Kërkuesi e pranon argumentin e Lidhjes, por kërkon që t'i lejohet që posterin ta filmojë me fotoaparatin e vet digjital, gjë që do t'i mundësojë që në ndonjë vend tjetër ta punojë kopjen e dokumentit autentik me origjinalin, kurse personi i autorizuar e kënaq këtë kërkesë.

8. Sa kushton qasja informatave?

Njoftimi për atë nëse organi i pushtetit e disponon informatën e kërkuar, si dhe shikimi i dokumentit i cili e përmban këtë informatë, është pa pagesë.

Kërkuesi ka obligim ta paguaj kompensimin e nevojshem të shpenzimeve të punimit të kopjes së dokumentit dhe të dërgimit të tij. Shpenzimet e kopjimit i cakton Qeveria e Republikës së Serbisë.

Nga detyrimi i pagesë së kompensimit për punimin e kopjes janë të liruar:

- gazetarët, nëse kopjen e kërkojnë për ta ushtruar profesionin e vet;
- shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në qoftë se kopjen e dokumentit e kërkojnë për realizimin e objektivave të shoqatës;
- të gjithë personat, në qoftë se informata e kërkuar ka të bëjë me rrezikimin, respektivisht mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe të ambientit.

Kur informata e kërkuar veç është publikuar dhe është e përshtatshme në vend, por edhe në internet, nuk mund të realizohet e drejta për kopje pa pagesë.

9. Si vepron organi i pushtetit kur e shkurton qasjen informatës?

Nëse organi i pushtetit për shkaqe të cekura në pjesën III të udhëzimit e refuzon, në tërësi apo pjesërisht, kërkesën e kërkuesit ka për detyrë që për këtë të nxjerrë aktvendim të veçantë.

Aktvendimi për refuzimin duhet të arsyetohet me shkrim. Organi i pushtetit ka për detyrë që kërkuesin ta udhëzojë në këshilla juridike që mund t'i ushtrojë kundër aktvendimit për refuzim.

10. Kur organi i pushtetit ia përcjell kërkesën Komisarit?

Në qoftë se organi i pushtetit nuk e disponon dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar, do t'ia përcjell kërkesën për qasje informatës Komisarit. Njëkohësisht, do ta njoftojë Komisararin dhe kërkuesin për atë se në disponim të kujt, sipas njohurisë së tij, gjendet dokumenti.

Komisari ka për detyrë ta verifikojë nëse organi, të cilit më parë i është dërguar kërkesa, vërtet nuk e disponon informatën e kërkuar. Në qoftë se Komisarari konstaton se informata e kërkuar gjendet në disponim të ndonjë organi tjetër të pushtetit, ai do t'ia:

- përcjellë kërkesën atij organi, ose
- do ta udhëzojë kërkuesin që t'i drejtohet vetë.

Me qenëse kërkuesi mbetet “zotrues” i kërkesës së vet, ai mund ta kundërshtojë përcjelljen e kërkesës ndonjë organi tjetër. Përparësia e përcjelljes së kërkesës ndonjë organi tjetër është në faktin që kërkuesi nuk është i detyruar të paraqesë kërkesë tjetër. Afati për procedim sipas kërkesës së përcjellë, fillon të rrjedhë nga dita e dërgimit të kërkesës organit tjetër.

Shembull: Studenti e përgatit seminarin e punës në temën e dhunës në familje në Serbi. I drejtohet Ministrisë së Drejtësisë në mënyrë që të marrë informatën se sa fletëdenoncime janë paraqitur nga normimi i kësaj vepre penale që kanë të bëjnë me atë, sa procedura janë inicuar dhe sa nga ato kanë përfunduar me aktgjykime dënuese. Të themi se Ministria nuk e disponon këtë informatë, por personi i autorizuar për qasje informatave e ka të njohur se të dhëna të tilla ka Enti për Statistikë,

ose pjesërisht këto informata i disponon Ministria e Punëve të Brendshme, Gjykata e Lartë dhe Prokurori Publik Republikan. Personi i autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për këtë e njofton Komisararin dhe kërkuesin e informatës dhe ia përcjellë kërkesën Komisararit.

11. Kur është e mundshme t'i ushtrohet ankesa Komisararit?

Ankesa ndaj vendimit të organit, të cilit i është bërë kërkesa për qasje informatës, mund t'i paraqitet Komisararit në qoftë se organi i pushtetit:

- e refuzon, në tërësi ose pjesërisht, kërkuesin e kërkesës;
- nuk procedon sipas kërkesës së kërkesës në afatin e normuar në ligj (“heshtja e administratës”);
- nuk e mundëson të shikuarit e dokumentit, i cili e përmban informatën e kërkuar me përdorimin e pajisjes të cilën e disponon vet, respektivisht nuk ia lejon kërkesës të bëjë shikimin e dokumentit me përdorimin e pajisjes së vet;
- e kushtëzon lëshimin e kopjes së dokumentit me pagesën e kompensimit i cili e kalon shumë e nevojshme të shpenzimeve të punimit të kopjes;
- nuk e jep për shikim dokumentin, respektivisht nuk e punon kopjen e atij dokumenti në gjuhën në të cilën është paraqitur kërkesa, edhe pse e disponon dokumentin në atë gjuhë.

Kërkesi mund t'i deklarojë ankesë Komisararit në afatin prej 15 ditësh, nga dita e dërgimit të akvendimit për refuzimin e kërkesës, ose nga dita kur nuk i është mundësuar ta realizojë të drejtën për qasje informatave, në pajtim me këtë Ligj.

Kërkesi ia dorëzon ankesën Komisararit nëpërmjet organit të pushtetit të cilit i është paraqitur kërkesa.

Shembull: Kërkesi i ka paraqitur kërkesë Sekretariatit Krahinor për Arsim e Kulturë për qasje informatës mbi manifestimet kulturore të cilat me mbështetje të këtij sekretariati janë organizuar gjatë vitit të kaluar. Mund t'i ankohet Komisararit në qoftë se:

- * *Nuk merr kurrfarë përgjigje;*
- * *Merr përgjigje se Sekretariati nuk e ka informatën e tillë;*
- * *Nuk e merr përgjigjen në afatin ligjor;*
- * *Sekretariati e kushtëzon dhënien e dokumentit që e përmban listën e manifestimeve, me pagesën e kompensimit për kopjimin që i tejkalon shpenzimet e nevojshme (p.sh. kompensimi dyfishë më i madh nga çmimi që e paguajnë për një faqe aparatet kopjative private, ose çmimi që e tejkalon atë nga çmimorja e shpenzimeve që e ka caktuar Qeveria e Serbisë);*
- * *Kërkesi kërkon që dokumentet të cilat përmbajnë informatën, të skanohen në aparatet e tij (të cilin ia ka sjellë Sekretariatit), kurse personi i autorizuar këtë nuk ia lejon duke insistuar në përdorimin e aparatit zyrtar për kopjim;*
- * *Kërkesi e paraqet kërkesën në gjuhën sllovaqe, Sekretariati e disponon listën e kërkuar edhe në këtë gjuhë, por në vend të asaj i ofron shikimin e dokumentit në gjuhën serbe.*

12. Kur nuk lejohet ankesa

Ankesa nuk lejohet në qoftë se kërkuesi është refuzuar, respektivisht nëse nuk i është mundësuar ta realizojë të drejtën për qasje informatave në harmoni me Ligjin nga ana e këtyre organeve të shtetit.

- Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë

- Presidentit të Republikës
- Qeverisë së Republikës së Serbisë
- Gjykatës së Lartë të Serbisë
- Gjykatës Kushtetuese të Serbisë
- Prokurorit Publik Republikan.

Kundër aktvendimit të këtyre organeve mund të zhvillohet kontesti administrativ para gjykatës kompetente në harmoni me Ligjin.

13. Si vendos Komisari lidhur me ankesën?

Komisari lidhur me ankesën vendos pa shtyerje, e më së voni në afatin prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës.

Komisari do t'ia mundësojë organit të pushtetit dhe kërkuesit që të deklarohen me shkrim rreth thekseve nga ankesa.

Duke proceduar sipas ankesës, Komisari i verifikon dhe i konstaton faktet e domosdoshme për marrjen e aktvendimit. Me atë rast Komisari ka të drejtë ta shikojë çdo dokument, përfshirë edhe atë i cili për çfarëdo arsye i është kufizuar kërkuesit.

14. Çfarë është efekti i vendimit të Komisarit?

Aktvendimi i Komisarit e obligon organin e pushtetit i cili kërkuesit ia ka kufizuar qasjen informatës. Duke vendosur lidhur me ankesën, Komisari në çdo rast konkret ka të drejtë që kërkuesit t'ia mundësojë vetë qasjen informatave.

Sipas nevojës, për ekzekutimin e vendimit të Komisarit, kujdeset Qeveria e Republikës së Serbisë.

15. Çka nëse kërkuesi është i pakënaqur me vendimin e Komisarit?

Nëse kërkuesi është i pakënaqur me aktvendimin e Komisarit, ose në qoftë se Komisari nuk e merr aktvendimin në afatin e normuar, kërkuesi mund ta inicojë kontestin administrativ para gjykatës kompetente.

Kontesti administrativ është formë e jashtme e kontrollit gjyqësor të punës së organeve të shtetit. Padia i paraqitet dhe i dorëzohet direkt gjykatës kompetente në afatin prej 30 ditësh, nga dita e dërgimit të aktvendimit.

Në qoftë se Komisari nuk vendos lidhur me ankesën në afatin e normuar, kërkuesi mund të kërkojë nga ai që ta marrë aktvendimin në afatin plotësues prej 7 ditësh. Në qoftë se Komisari edhe atëherë nuk e merr aktvendimin, kërkuesi mund t'ia paraqes padinë gjykatës në afatin prej 30 ditësh, nga dita e skadimit të afatit plotësues.

16. Çka duhet të përmbaj padia?

Në padi duhet të ceken këto të dhëna:

- emri e mbiemri, profesioni dhe vendbanimi, respektivisht emri dhe selia e paditësit;
- aktvendimi i Komisarit, respektivisht i organit të pushtetit kundër aktvendimit të së cilit nuk është e lejueshme ankesa (shihe pikën 12 të udhërrefyesit);
- shkaqet për paraqitjen e padisë; dhe
- në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktvendimit.

17. Edhe çka mund të bëhet nëse organi i pushtetit nuk i përmbush detyrimet e veta ligjore?

Secili ka të drejtë ta njoftojë Komisararin se organi i pushtetit nuk po i përmbush detyrimet ligjore, e sidomos:

- Detyrimin e ndërtimit dhe të publikimit të informatorit me të dhënat themelore për punën e vet (neni39);
- Detyrimin e ruajtjes së bartësitë të informatës sipas mënyrës e cila do të mundësojë realizimin pa pengesa të drejtës për qasje informatave (neni 41);
- Detyrimin e aftësimin të punësuarve për zbatimin e dispozitave ligjore (neni 42).

Duke proceduar sipas fletparaqitjes, Komisarari mund të marrë aktvendimin me të cilin konstaton se organi i pushtetit nuk e ka kryer detyrimin e vet dhe t'i urdhërojë masat për kryerjen e tij.

Shembulli: Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar kopjen e informatorit me të dhënat themelore mbi punën e komunës. I është dhënë përgjigja se informatori i tillë ende nuk është punuar. Kërkuesi mund t'i paraqes ankesë Komisararit në qoftë se dyshon se informatori megjithatë ekziston, por personi i autorizuar në komunë nuk ka dashur t'ia jap. Mirëpo, në qoftë se informatori vërtet nuk ekziston, kërkuesi nuk do të mund ta marrë as pas vendimit të Komisararit, sipas ankesës. Nga ana tjetër, kërkuesi i refuzuar ose kushdo tjetër, mund t'ia paraqesë Komisararit se komuna nuk e ka kryer detyrimin e vet lidhur me masat për avancimin e transparencës së punës, pas çkahit Komisarari mund t'i urdhërojë komunës ta bëjë këtë.

Përpos kësaj duhet theksuar se ministria kompetente për punët e informimit bën mbikqyrjen e zbatimit të këtij Ligji, dhe ajo duhet të reagojë në të gjitha situatat kur ekziston pengesa evidente në zbatimin e Ligjit.

Shtojca 1

L I G J I

MBI QASJEN E LIRË INFORMATAVE ME RËNDËSI PUBLIKE

I. DISPOZITAT THEMELORE

Lënda e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen të drejtat për qasje informatave me interes publik të cilat i disponojnë organet e pushtetit publik, për realizimin dhe mbrojtjen e interesave të opinionit për të ditur, dhe të realizimit të rendit të lirë demokratik dhe të shoqërisë së hapur.

Për realizimin e të drejtave për qasje informatave me rëndësi publike të cilat i disponojnë organet e pushtetit publik, me këtë Ligj inaugurohet Komisarari për informata me rëndësi publike (në tekstin e mëtejshëm: Komisarari), si organ i mëvetësishëm i shtetit, i pavarur në ushtrimin e kompetencës së vet.

Informatat me rëndësi publike

Neni 2

Informata me rëndësi publike, në kuptimin e këtij Ligji, është informata të cilën e disponon organi i pushtetit publik, buron në punën ose lidhur me punën e organit të pushtetit publik, që e përmban dokument përkatës e ka të bëjë me krejt atë për të cilën opinionin ka interes të arsyeshëm të dijë. Që ndonjë informatë të konsiderohet informatë me rëndësi publike nuk është me rëndësi nëse burimi i informatës është organi i pushtetit publik ose ndonjë person tjetër, nuk është me rëndësi bartësi i informatave (letra, shiriti, filmi, mediumi elektronik e ngjashëm) ku gjendet dokumenti i cili e përmban informatën, ditën e lindjes së informatës, mënyrën e mësimin të informatës, e as që janë të qenësishme vetitë e tjera të ngjashme të informatës.

Organi i pushtetit publik

Neni 3

Organi i pushtetit publik (në tekstin e mëtejshëm: organi i pushtetit) në kuptimin e këtij Ligji është:

- 1) organi i shtetit, organi i autonomisë territoriale, organi i vetëqeverisjes lokale, si dhe organizata të cilës i është besuar ushtrimi i kompetencave publike (në tekstin e mëtejshëm: organi i shtetit)
- 2) personi juridik të cilin e formon ose financon në tërësi, respektivisht në pjesën mbisunduese organi i shtetit.

Bazat ligjore mbi interesin e arsyeshëm

Neni 4

Konsiderohet se interesi i arsyeshëm i opinionit për të ditur, nga neni 2 i këtij Ligji, ekziston gjithmonë kur është fjala për informatat të cilat i disponon organi i pushtetit që kanë të bëjnë me rrezikimin, respektivisht mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe të ambientit, e nëse është fjala për informatat tjera të cilat i disponon organi i pushtetit, konsiderohet se interesi i arsyeshëm i opinionit të dinë, nga neni 2 i këtij Ligji ekziston, përpos në qoftë se organi i pushtetit e dëshmon të kundërtën.

Përmbajtja e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike

Neni 5

Secili ka të drejtë t'i kumtohet nëse organi i pushtetit e disponon informatën e caktuar me rëndësi publike, respektivisht nëse ajo, ndryshe i është e përshtatshme.

Secili ka të drejtë që informata me rëndësi publike t'i bëhet e përshtatshme ashtu që do t'i mundësohet shikimi në dokumentin i cili e përmban informatën me rëndësi publike, të drejtën e kopjes së atij dokumenti, si dhe të drejtën që me kërkesë, kopja e dokumentit t'i dërgohet me postë, faks, postë elektronike ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Barazia parimore

Neni 6

Të drejtat nga ky Ligj u takojnë të gjithëve nën kushte të barabarta, pavarësisht nga shtetësia, vendbanimi, vendqendrimi, respektivisht selia ose vetia personale sikurse është raca, predikimi fetar, përkatësia kombëtare dhe etnike, gjinia e ngjashëm.

Ndalimi i diskriminimit të gazetarëve dhe të mjeteve publike

Neni 7

Organi i pushtetit nuk guxon ta vë në pozitë më të mirë asnjë gazetarë ose mjet publik, kur disa nga ato kanë drejtuar kërkesë, ashtu që vetëm atij ose asaj, para se gazeatrëve tjerë ose mjeteve publike, t'u mundësojë realizimin e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike.

Kufizimet e të drejtave

Neni 8

Të drejtat nga ky Ligj mund t'u nënshtrohen jashtëzakonshem kufizimeve të normuara me këtë Ligj, nëse kjo është e domosdoshme në shoqërinë demokartike për mbrojtjen nga cenimet serioze të intersave mbisunduese të mbështetura në kushtetutë ose ligj.

Asnjë dispozitë e këtij Ligji nuk mund të interpretohet sipas mënyrës e cila do të sjellte anulimin e ndonjë të drejte që e njeh ky ligj ose kufizimin e saj në masën më të madhe nga ajo që është normuar me paragrafin 1, të këtij Ligji.

II. PËRJASHTIMI DHE KUFIZIMI I QASJES SË LIRË INFORMATAVE ME RËNDËSI PUBLIKE

Jeta, shëndeti, siguria, gjyqësia, mbrojtja e vendit, siguria kombëtare e publike, mirëqenia ekonomike e vendit dhe sekretet

Neni 9

Organi i pushtetit nuk do t'ia mundësojë kërkuesit realizimin e të drejtës për qasje informatave me inteser publik, nëse me këtë:

- 1) do të rrezikohej jeta, shëndeti, siguria ose ndonjë e mirë tjetër e rëndësishme e ndojnë personi;
- 2) do të rrezikohej, pengohej ose vështirësohej pengimi a zbulimi i veprës penale, akuzimi për vepër penale, zhvillimi i proecedurës parapenale, zhvillimi i procedurës gjyqësore, ekzekutimi i aktgjykimit ose zbatimi i denimit, apo ndonjë procedurë tjetër e rregulluar juridikisht apo procedim fer dhe gjykim i drejtë;
- 3) do të rrezikohej seriozisht mbrojtja e vendit, siguria kombëtare apo publike ose marrëdhëniet ndërkombëtare;
- 4) do të pakësohej qenësisht aftësia e shtetit për të menaxhuar proceset ekonomike në vend ose do të vështirësohej qenësisht realizimi i interesave të arsyeshme ekonomike;
- 5) do ta bënte të përshtatshme informatën ose dokuemntin për të cilën, me dispozita ose akte zyrtar të mbështetur në ligj, është caktuar të ruhet si sekret shtetëror, zyrtar, afarist apo sekret tejtër, respektivisht që është i përshtatshem vetëm rrethit të caktuar të personave e për tradhtimin e së cilës mund të shkaktohen pasoja juridike ose tjera për interesat e mbrojtura me ligj të cilat e tejkalojnë interesin për qasje informatës.

Informata me rëndësi publike në disponim të organit të pushtetit e cila i është e përshtatshme për opinionin

Neni 10

Organi i pushtetit nuk është e thënëun t'ia mundësojë kërkuesit realizimin e të dretjës për qasje informatave me rëndësi publike nëse fjala është për informatën e cila veç është publikuar dhe është e përshtatshme në vend ose në internet.

Në rastin nga paragrafi 1, i këtij neni, organi i pushtetit në përgjigjen në kërkesë do ta emërtojë bartësinë e informatës (numrin e gazetës zyrtare, emrin e publikimit, e ngjashëm), ku dhe kur është publikuar informata e kërkuar, përpos nëse kjo është e gjithënjohur.

Kontestimi i publikimit të informatës nga ana e organit të pushtetit

Neni 11

Në qoftë se organi i pushtetit e konteston vërtetësinë ose tërësinë e informimit me rëndësi publike e cila është publikuar, do ta kumtojë informatën e vërtetë dhe të plotë, respektivisht do të mundësojë shikimin në dokument i cili e përmban informatën e vërtetë dhe të plotë, përpos në rastet nga neni 9 dhe 14 i këtij Ligji.

Veçimi i informatave

Neni 12

Në qoftë se informata e kërkuar me rëndësi publike mund të veçohet nga informatat tjera në dokument, në të cilin organi i pushtetit nuk është i obligueshem t'ia mundësojë shikimin, organi i pushtetit do t'ia mundësojë kërkuar shikimin në pjesën e dokumentit i cili e përmban vetëm informatën e veçuar.

Keqpërdorimi i qasjes së lirë informatave me rëndësi publike

Neni 13

Organi i pushtetit nuk do t'ia mundësojë kërkuar realizimin e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike nëse kërkuar dhe keqpërdor të drejtën për qasje informatave me rëndësi publike, sidomos nëse kërkimi është i pakuptueshem, shpesh kur përsëritet kërkimi për informatën e njëjtë ose për informatat veç të marra, ose kur kërkohet një numër tepër i madh i informatave.

Privatësia dhe të drejtat e tjera të personalitetit

Neni 14

Organi i pushtetit nuk do t'ia mundësojë kërkuar realizimin e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike nëse me këtë do të cenohej e drejta për privatësi, e drejta për prestigj ose ndonjë e drejtë tjetër e personit për të cilin ka të bëjë personalisht informata, përpos:

- 1) në qoftë se personi është pajtuar me këtë;
- 2) në qoftë se është fjala për personalitetin, dukurinë ose ngjarjen me interes për opinionin, e sidomos nëse është fjala për bartësin e funksionit shtetëror e publik dhe në qoftë se informata është e rëndësishme duke marrë parasysh funksionin që e ushtron ai person;
- 3) në qoftë se është fjala për personin i cili me sjelljen e vet, sidomos lidhur me jetën private, ka dhënë shkas për kërkimin e informatës.

III. PROCEDIMI PARA ORGANIT TË PUSHTETIT

Kërkesa për njoftim, shikim, lëshim kopje dhe udhëzim

Neni 15

Kërkuar ia paraqet kërkesën me shkrim organit të pushtetit për realizimin e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike (në tekstin e mëtejshëm: kërkesa).

Kërkesa duhet ta mbajë emrin e organit të pushtetit, emrin, mbiemrin dhe adresën e kërkuar, si dhe përshkrimin sa më të saktë të informatës e cila kërkohet.

Kërkesa mund të mbajë edhe të dhënat tjera të cilat e lehtësojnë gjetjen e informatës së kërkuar. Kërkuesi duhet t'i cekë arsyet për kërkesë.

Nëse kërkuesi nuk i mban të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni, respektivisht nëse kërkuesi nuk është nën regull, personi i autorizuar i organit të pushtetit është i obliguar që, pa kompenzim, ta mësojë kërkuesin si t'i eliminojë ato mangësi, respektivisht t'ia dërgojë kërkuesit udhëzimin për plotësim.

Në qoftë se kërkuesi nuk i eliminon mangësitë në afatin e caktuar, respektivisht në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së udhëzimit për plotësim, kurse mangësitë janë t'atilla që sipas kërkuesit nuk mund të procedohet, organi i pushtetit do ta nxjerrë prëfudnimin për refuzimin e kërkesës si të parregulltë.

Organi i pushtetit është i obligueshëm ta mundësojë qasjen informatave edhe në bazë të kërkesës me gojë të kërkuesit e cila kumtohet në procesverbal, me ç'rast kërkesa e tillë futet në evidencë të veçantë dhe zbatohen afatet sikur kërkesa të është parritur me shkrim.

Organi i pushtetit mund të normojë formular për paraqitjen e kërkesës, por duhet ta shqyrtojë edhe kërkesën e cila nuk është bërë në atë formulë.

Vendosja për kërkesën

Neni 16

Organi i pushtetit ka detyrë që pa shtyrje, e më së voni në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, ta njoftojë kërkuesin për disponimin e informatës, t'ia jap për ta parë dokumentin i cili e mbanë informatën e kërkuar, respektivisht ia lëshon ose dërgon kopjen e atij dokumenti. Kopja e dokumentit i është dërguar kërkuesit me ditën kur ka dalë nga zyra e shkresave të organit të pushtetit prej të cilit është kërkuar informata.

Në qoftë se kërkesa ka të bëjë me informatën për të cilën mund të supozohet se është me rëndësi për mbrojtjen e jetës ose të lirisë së ndonjë personi, respektivisht për rrezikimin ose mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe të ambientit të njeriut, organi i pushtetit duhet ta njoftojë kërkuesin mbi disponimin e asaj informate, që t'ia jap në shikim dokumentin i cili e mban informatën e kërkuar, respektivisht që t'ia lëshojë kopjen e atij dokumenti, më së voni në afatin prej 48 orësh nga pranimi i kërkesës.

Në qoftë se organi i pushtetit nuk ka mundësi, për shkaqe të arsyeshme, që në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni ta njoftojë kërkuesin mbi disponimin e informatës, që t'ia jap për shikim dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar, që t'ia lëshojë, respektivisht dërgojë kopjen e dokumentit, ka për detyrë që për këtë ta njoftojë menjëherë kërkuesin dhe ta caktojë afatin tjetër i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 40 ditë nga dita e pranimit të kërkesës, në të cilin do ta njoftojë kërkuesin mbi posedimin e informatës, t'ia jap për shikim dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar, t'ia lëshojë respektivisht dërgojë kopjen e atij dokumenti.

Në qoftë se organi i pushtetit nuk përgjigjet në afat, kërkuesi mund t'ia ushtrojë ankesë Komisarit, përpos në rastet e caktuara me këtë Ligj.

Organi i pushtetit bashkë me njoftimin mbi atë se kërkuesit do t'ia jap në shikim dokumentin i cili e mbanë informatën e kërkuar, respektivisht do t'ia lëshojë kopjen e atij dokumenti, do t'ia kumtojë kërkuesit kohën, vendin dhe mënyrën se si do t'ia dërgohet informata në shikim, shumën e shpenzimeve të nevojshme të punimit të kopjes së dokumentit, e në rast se nuk disponon mjete teknike për punimin e kopjes, do ta njoh kërkuesin me mundësinë që ta punojë kopjen me përdorimin e pajisjes së vet.

Shikimi i dokumentit i cili e përmban informatën e kërkuar bëhet në lokalet zyrtare të organit të pushtetit. Kërkuesi mund për shkaqe të arsyeshme të krëkojë që shikimi në dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar të bëhet në ndonjë kohë tjetër nga koja të cilëne ia ka caktuar organi i pushtetit i cili është kërkuar informata.

Personit, i cili nuk është në gjendje që pa shoqërues ta bëjë shikimin në dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar, do t'ia mundësohet që këtë ta bëjë me ndihmën e shoqëruesit.

Nëse e plotëson kërkesën, organi i pushtetit nuk do të lëshojë aktvendim të veçantë, por për këtë do të mbajë shënim zyrtar.

Në qoftë se organi i pushtetit refuzon që në tërësi ose pjesërisht ta njoftojë kërkuesin mbi disponimin e informatës, për t'ia dhënë për shikim dokumentin, i cili e përmban informatën e kërkuar, për t'ia lëshuar respektivisht dërguar kopjen e atij dokumenti, ka për detyrë të marrë aktvendim për refuzimin e kërkesës dhe atë aktvendim ta arsyetojë me shkrim, si dhe në aktvendim ta udhëzojë kërkuesin në mjete juridike, të cilat mund t'i deklarojë kundër aktvendimit të tillë.

Kompensimi

Neni 17

Shikimi në dokumentin, i cili e përbën informatën e kërkuar është pa pagesë.

Kopja e dokumentit, i cili e përmban informatën e kërkuar, lëshohet me detyrimin e kërkuesit që ta paguaj kompensimin e shpenzimeve të nevojshme për punimin e asaj kopje, e në rast të dërgimit edhe shpenzimet e dërgimit.

Qeveria e cakton çmimoren e shpenzimeve në bazë të së cilës organi i llogarit shpenzimet nga paragrafi i mëparshëm

Nga detyra e pagimit të kompensimit nga paragrafi 2, i këtij neni, janë të liruar gazetarët, kur kopjen e dokumentit e kërkojnë për ushtrimin e profesionit të vet, shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kur kopjen e dokumentit e kërkojnë për realizimin e objektivave të shoqatës dhe të gjithë personat kur informata e kërkuar ka të bëjë me rrezikimin, respektivisht mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe të ambientit të njeriut, përpos në rastet nga neni 10, paragrafi 1, i këtij Ligji.

Komisari e përcjell praktikën e pagesës së kompensimit dhe të lirimit nga kompensimi, dhe u drejton rekomandime organeve të pushtetit për njëjtësimin e kësaj praktike.

Dhënia në shikim dhe punimi i kopjes

Neni 18

Shikimi në dokument i cili e mban informatën e kërkuar bëhet me përdorimin e pasisjes të cilën e disponon organi i pushtetit, përpos kur kërkuesi kërkon që shikimi të bëhet me përdorimin e pajisjes së vet.

Organi i pushtetit e lëshon kopjen e dokumentit (fotokopjen, audio kopjen, video kopjen, kopjen digjitale, e ngjashem) i cili e mbanë informatën e kërkuar në formën në të cilën gjendet informata. Në qoftë se organi i pushtetit nuk disponon mundësi teknike për punimin e kopjes së dokumentit në kuptimin e paragrafi 2, të këtij neni, kopjen e dokumentit do ta punojë në formë tjetër.

Në qoftë se organi i pushtetit e disponon dokumentin i cili e mbanë informatën e kërkuar në gjuhën në të cilën është paraqitur kërkesa, ka për detyrë që kërkuesit t'ia vë në shikim dokumentin dhe ta punojë kopjen në gjuhën në të cilën është paraqitur kërkesa.

Përcjellja e kërkesës Komisarit

Neni 19

Kur organi i pushtetit nuk e disponon dokumentin i cili e mbanë informatën e kërkuar, kërkesën do t'ia përcjellë Komisarit dhe do ta njoftojë Komisarin dhe kërkuesin për atë se në disponim të kujt gjendet dokumenti, sipas njohurive të tij.

Procedimi i Komisarit ndaj kërkesës së përcjellë

Neni 20

Me të marrë kërkesën, Komisari e verifikon nëse dokumenti që e mban informatën e kërkuar, me të cilën ka të bëjë kërkesa, gjendet në disponim të organit të pushtetit i cili ia ka përcjellur kërkesën.

Në qoftë se konstaton se dokumenti nga paragrafi 1, i këtij neni nuk gjendet në disponim të organit të pushtetit i cili ia ka përcjellur kërkesën e kërkuarit, Komisari do t'ia dorëzojë kërkesën organit të pushtetit i cili e disponon atë dokument, përpos nëse kërkuari e ka caktuar ndryshe, dhe për atë do të njoftojë kërkuarin, ose kërkuarin do ta udhëzojë në organin e pushtetit në disponim të të cilit gjendet informata e kërkuar.

Mënyrën e procedimit nga paragrafi 2, të këtij neni e përcakton Komisari varësisht nga fakti se në çfarë mënyrë është më efikas realizimi i të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike. Në qoftë se Komisari ia dorëzonë kërkesën organit të pushtetit nga paragrafi 2, i këtij neni, afati i parashikuar me nenin 16, të këtij Ligji, fillon të rrjedhë nga dita e dorëzimit.

Dispozitat tjera të procedimit

Neni 21

Në procedimin para organit të pushtetit zbatohen dispozitat e Ligjit me të cilin rregullohet procedura e përgjithshme administrative, e që ka të bëjë me zgjidhjen e organit të shkallës së parë, përpos në qoftëse me këtë Ligj nuk është caktuar ndryshe.

IV. PROCEDIMI PARA KOMISARIT

E drejta për ankesë

Neni 22

Kërkuari mund t'i deklarojë ankesë Komisarit në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit të organit të pushtetit, në qoftë se:

- 1) organi i pushtetit, në kundërshtim me nenin 16, paragraf.1 dhe 3, të këtij Ligji, refuzon ta njoftojë kërkuarin për atë nëse e disponon informatën e caktuar me rëndësi publike ose ajo ndryshe i është e përshtatshme, për t'ia dhënë në shikim dokumentin që e mbanë informatën e kërkuar, t'ia lëshojë, respektivisht dërgojë kopjen e dokumentit, ose në qoftë se këtë nuk e bënë në afatit e normuar;
- 2) organi i pushtetit, në kundërshtim me nenin 16, paragraf. 2, të këtij Ligji, nuk përgjigjet në afatin e normuar në kërkesën e kërkuarit;
- 3) organi i pushtetit, në kundërshtim me nenin 17, paragraf. 2, të këtij Ligji, e kushtëzon dhënjën e kopjes së dokumentit i cili e përmban informatën e kërkuar me pagesën e kompenzimit e cila e tejkalon shumë e nevojshme të shpenzimeve të punimit të asaj kopje;
- 4) organi i pushtetit nuk e jep në shikim dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar sipas mënyrës së parashikuar me nenin 18, paragraf.1, të këtij Ligji;
- 5) organi i pushtetit nuk e jep në shikim dokumentin i cili e mbanë informatën e kërkuar, respektivisht nuk e lëshon kopjen e atij dokumenti, sipas mënyrës së parashikuar me nenin 18, paragraf. 4, të këtij Ligji.

Kundër aktvendimit të Kuvendit Popullor, Presidentit të Republikës, Qeverisë së Republikës së Serbisë, Gjykatës së Lartë të Serbisë, Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorit Publik Republikan, nuk mund të deklarohet ankesa.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 2, të këtij Ligji mund të inicohet kontesti administrativ në përputhje me ligjin, për çka gjykata sipas detyrës zyrtare e njofton Komisarin.

Aktvendimi i Komisarit sipas ankesës

Neni 23

Në procedimin para Komisarit zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet procedura e përgjithshme administrative, e që ka të bëjë me zgjidhjen e ankesës nga organi i shkallës së dytë, përpos në qoftë se me këtë Ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 24

Komisari e merr aktvendimin pa shtyrje, e më së voni në afatin prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës, pasi t'ia mundësojë organit të pushtetit që të deklarohet me shkrim, e sipas nevojës edhe kërkesit

Komisari e refuzon ankesën e cila nuk është e lejueshme, jo me kohë dhe është deklaruar nga ana e personit të paautorizuar.

Organi i pushtetit dëshmon se ka proceduar në përputhje me obligimet e veta të parashikuara me këtë Ligj.

Marrja e vendimit të Komisarit lidhur me masat për avancimin e transparencës së punës

Neni 25

Komisari mundet, sipas denoncimit ose sipas detyrës zyrtare të marrë aktvendimin me të cilin konstatohet se organi i pushtetit, përpos organit nga neni 22, paragrafi 2, të këtij Ligji, nuk i ka kryer obligimet e veta të parashikuara me këtë Ligj dhe ti urdhërojë masat për kryerjen e tyre, pasi që paraprakisht t'ia mundësoj organit të pushtetit që të deklarohet me shkrim.

Denoncimi nga paragrafi 1, i këtij neni nuk mund të paraqitet, kur me këtë ligj është parashikuar e drejta e ankesës.

Konstatimi i gjendjes faktike nga ana e Komisarit

Neni 26

Komisari ndërmerr veprime për konstatimin e gjendjes faktike që janë të domosdoshme për marrjen e aktvendimit nga neni 24 dhe 25 të këtij Ligji.

Komisarit, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike nga paragrafi 1, të këtij neni, do t'i mundësohet shikimi i secilit bartës të informatës ndaj të cilit aplikohet ky Ligj.

Këshilla juridike kundër aktvendimit të Komisarit

Neni 27

Kundër aktvendimit të Komisarit mund të inicohet kontesti administrativ

Detyrueshmëria e aktvendimieve dhe e konkluzioneve

Neni 28

Aktveidmet dhe konkluzionet e Komisarit janë të detyrueshme

Ekzekutimin e avktvendimeve dhe të konkluzioneve të Komisarit, në rast nevoje, e siguron Qeveria e Republikës së Serbisë.

V. ZGJEDHJA, POZITA DHE KOMPETENCAT E KOMISARIT

Selia e Komisarit

Neni 29

Selia e Komisarit është në Beograd.

Zgjedhja

Neni 30

Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë (në tekstin e mëtejshem: Kuvendi Popullor), e zgjedh Komisarin me propozim të Këshillit të Kuvendit Popullor kompetent për informim. Komisar zgjidhet personi me prestigj të njohur dhe me profesionalizëm në fushën e mbrojtjes dhe avancimit të drejtave të njeriut.

Komisiari mund të jetë person, i cili i përmbush kushtet për punë në organet e shtetit, që e ka të kryer fakultetin e drejtësisë dhe ka të paktën dhjetë vjetë përvojë pune.

Komisar nuk mund të jetë personi i cili e ushtron funksionin ose është i punësuar në organin tjetër të shtetit ose në partinë politike.

Komisiari zgjidhet për kohën prej shtatë vjetësh.

Personi i njëjtë mund të zgjedhet Komisar më së shumti dy herë.

Pushimi i mandatit

Neni 31

Komisarit i pushon detyra me skadimin e mandatit, me kërkuesë personale, kur i mbush gjashtëdhjetë e pesë vjetë jete, dhe me shkarkim.

Vendimin për pushimin e detyrës së Komisarit e merrë Kuvendi Popullor.

Komisiari shkarkohet nga detyra në qoftë se gjykohet për vepër penale me dënim me burg, në qoftë se e humb përgjithmonë aftësinë e punës, në qoftë se e ushtron ose është punësuar në ndonjë organ të shtetit ose parti politike, në qoftë se e humb shtetësinë e Republikës së Serbisë apo në qoftë se jo profesionalisht dhe pandërgjegje e ushtron punën.

Procedura për shkarkimin Komisarit merret me iniciativën e një të tretës së deputetëve popullor.

Këshilli i Kuvendit të Serbisë kompetent për informim konstaton nëse ekzistojnë arsyet për shkarkimin, dhe për këtë e njofton Kuvendin Popullor.

Këshilli i Kuvendit të Serbisë kompetent për informim e njofton Kuvendin Popullor edhe për kërkesën e Komisarit që t'i pushojë detyra, si dhe për përmbushjen e kushteve për pushimin e detyrës për shkak të viteve të jetës.

Në qoftë se mbi kërkesën për pushimin e detyrës Kuvendi Popullor nuk vendos në afatin prej 60 ditësh, konsiderohet se me kalimin e këtij afati Komisarit i pushon detyra.

Në rastet e tjera Komisarit detyra i pushon atë ditë të cilën Kuvendi Popullor e cek në vendimin e vet.

Pozita e Komisarit

Neni 32

Komisiari është i mëvetësishëm dhe i pavarur në ushtrimin e detyrës së vet.

Në ushtrimin e kompetencave të veta, Komisiari nuk do të kërkojë, as do të merr urdhëra dhe udhëzime nga organët e shtetit ose personat tjerë.

Komisari ka të drejtën e rrogës të njëjtë me rrogën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, si dhe të drejtat tjera mbi baza të punës në pajtim me ligjin, dhe të drejtën për kompenzimin e shpenzimeve të krijuara lidhur me ushtrimin e kompetencës së vet

Komisari nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin që e ka paraqitur ose propozimin që e ak dhënë në ushtrimin e kompetencës së vetë, kurse në procedurën e ngritur për shkak të veprës penale të kryer në ushtrimin e kompetencës së vetë, nuk mund të arrestohet pa miratimin e Kuvendit Popullor.

Zëvendësi i Komisarit

Neni 33

Komisari e ka zëvendësin, të cilin e zgjedh Kuvendi Popullor, me propozim të Komisarit.

Komisari e propozon zëvendës të vetin personin i cili i plotëson kushtet për punë në organet e shtetit.

Zëvendësi i Komisarit zgjedhet për kohën prej shtatë vjetësh.

Personi i njëjtë do të zgjedhet zëvendës i Komisarit më së shumti dy herë.

Zëvendësi i Komisarit e ushtron detyrën e Komisarit në rasti të mungesës së tij, të vdekjes, skadimit të mandatit, shkarkimit, si dhe të pengimit të përkohshëm apo të përhershëm për t'i ushtruar kompetencat e veta.

Zëvendësit të Komisarit i pushon detyra sipas mënyrës së parashikuar për pushimin e detyrës së Komisarit.

Procedura për shkarkimin e zëvendësit të Komisarit ngritet dhe me iniciativën e Komisarit.

Shërbimi profesional i Komisarit

Neni 34

Komisari e ka shërbimin profesional i cili e ndihmon në ushtrimin e kompetencave të tij.

Komisari nxjerrë akte për të cilët pëlqimin e jep Kuvendi Popullor, me të cilët e rregullon punën e shërbimit të vet profesional. Komisarit vendos autonom, në pajtim me ligjin, për pranimin e personave në marrëdhënie pune në shërbimin profesional, i udhëhequr nga nevoja e ushtrimit profesional dhe efikas të kompetencave të veta

Për të punësuarit në shërbimin profesional të Komisarit zbatohen normat mbi marrëdhënien e punës si për organet e shtetit.

Mjetet financiare për punën e Komisarit dhe të shërbimit të tij profesional sigurohen në buxhetin e Republikës së Serbisë.

Kompetencat e Komisarit

Neni 35

Komisari:

- 1) e përcjell respektimin e detyrimeve të organit të pushtetit të përcaktuara me këtë Ligj, dhe për këtë e njofton opinionin dhe Kuvendin Popullor;
- 2) jep iniciativa për nxjerrjen dhe ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike
- 3) u propozon organeve të pushtetit marrjen e masave me qëllim të avancimit të punës së tyre të rregulluar me këtë ligj;
- 4) ndërmerr masa të nevojshme për trajnimin e të punësuarve në organet e shtetit dhe njohjen e të punësuarve me detyrimet e veta, me të drejtat për qasje informatave me rëndësi publike, për zbatimin afikas të këtij Ligji;

- 5) i zgjidh ankesat kundër aktvendimit të organit të pushtetit me të cilat janë shkelur të drejtat e rregulluara me këtë Ligj;
- 6) e njofton opinionin për përmbajtjen e këtij Ligji si dhe për të drejtat e rregulluara me këtë ligj;
- 7) ushtron edhe punë tjera të caktuara me këtë Ligj.

Raportet

Neni 36

Në afatin prej tre muajsh nga përfundimi i vitit fiskal, Komisari ia paraqet Kuvendit Popullor raportin mbi veprimet e ndërmarra nga ana e organit të pushtetit për aplikimin e këtij Ligji, si dhe mbi veprimet dhe shpenzimet e veta.

Përpos raportit nga paragrafi 1, të këtij neni, Komisar ia paraqet Kuvendit Popullor edhe raportet tjera, kur vlerëson se kjo është e nevojshme.

VI. MASAT PËR AVANCIMIN E TRANSPARENCËS NË PUNËN E ORGANIT TË PUSHTETIT

Doracakut për realizimin e të drejtave

Neni 37

Komisari, pa shtyrje, boton dhe azhuron, në gjuhën serbe dhe në gjuhët të cilat në pajtim me ligjin janë caktuar si gjuhë në përdorim zyrtar, doracakun me udhëzime praktike për realizimin efikas të drejtave të caktuara me këtë Ligj.

Në doracakun nga paragrafi 1, i këtij neni, sidomos duhet të ceket përmbajtja dhe vëllimi i të drejtave për qasje informatave me rëndësi publike si dhe mënyra sipas të cilës mund të realizohet kjo e drejtë.

Është detyrim i Komisarit që, me anë të shtypit, mediave elektronike, internetit, tribunave publike dhe në mënyra tjera, ta njoh opinionin me përmbajtjen e doracakut nga paragrafi 1, i këtij neni

Personi i autorizuar i organit të pushtetit

Neni 38

Organi i pushtetit do ta caktojë një apo më shumë persona zyrtarë (në tekstin e mëtejshëm: personi zyrtar) për procedimin e kërkesës për qasje të lirë informatave me rëndësi publike.

Personi zyrtar:

- 1) i merr kërkesat, e njofton kërkuesin mbi disponimin e informatës dhe siguron shikimin në dokumentin, i cili e përmban informatën e kërkuar, respektivisht ia dorëzon informatën në mënyrë adekuate, e refuzon kërkesën me aktvendim, u ofron kërkuesve ndihmën e domosdoshme për realizimin e të drejtave të tyre të përcaktuara me këtë Ligj;
- 2) ndërmerr masa për avancimin e praktikës së procedimit me bartësit e informatave, të praktikës së mirëmbajtjes së bartësit të informatave, si dhe të praktikës së ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre.

Në qoftë se personi zyrtar nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është caktuar, për procedimin e kërkesës kompetent është udhëheqësi i organit të pushtetit.

Detyrimi i botimit të informatës

Neni 39

Organi i shtetit, të paktën një herë në vit e punon informatën me të dhënat themelore mbi punën e vet, e cila përmban në veçanti:

- 1) përshkrimin e kompetencave, obligimeve dhe të strukturës organizative;
- 2) të dhënat mbi buxhetin dhe mjetet e punës;
- 3) të dhënat në pikëpamje me llojet e shërbimeve që ua ofron direkt personave të interesuar;
- 4) procedimin e paraqitjes së kërkesës organit të shtetit, respektivisht deklarimin e ankesës kundër vendimeve, punëve dhe lëshimeve të tij;
- 5) kontrollin e kërkesave, ankesave dhe masave të tjera direkte të marra nga ana e personave të interesuar si dhe vendimeve të organit të shtetit me rastin e kërkesave të paraqitura dhe ankesave të ushtruara, respektivisht të masave të tjera direkte të marra nga ana e personave të interesuar;
- 6) të dhënat mbi mënyrën dhe vendin e ruajtjes së bartësit të informatave, llojit të informatave që i disponon, llojet e informatave që i jep në shikim, si dhe përshkrimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës;
- 7) emrat e eprorëve të organit të shtetit dhe përshkrimin e kompetencave dhe të detyrave të tyre, si dhe procedimet në bazë të cilëve ata i marrin vendimet;
- 8) rregullat dhe vendimet e organit të shtetit që kanë të bëjnë me transparencën e punës së atij organi (koha e punës, adresa, telefoni i kontaktit, shenjat e identifikimit, qasjes personave me nevoja të veçanta, pjesëmarrje në mbledhje, lejimet për audio e video incizime, e ngjashëm), si dhe çdo interpretim autentik i atyre vendimeve;
- 9) rregullat dhe vendimet për përjashtimin dhe kufizimin e transparencës së punës së organit të shtetit si dhe arsyetimi i tyre.

Organi i shtetit do t'ia mundësojë personit të interesuar, pa kompensim, shikimin e informatës, respektivisht do t'ia jep ekzemplarë të informatorit, me kompensimin e shpenzimeve të nevojshme.

Udhëzimi për botimin e informatorit

Neni 40.

Komisari jep udhëzim sipas të cilit botohet informatori nga neni 39, i këtij Ligji dhe ofron këshilla me kërkesë të organit të shtetit, me qëllim të përmbushjes së drejtë, të plotë dhe me kohë të detyrimeve për botimin e informatorit.

Mirëmbajtja e bartësit të informatës

Neni 41

Organi i pushtetit do t'i mirëmbajë bartësit e informatave ashtu që të mundësojë realizimin e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike, në pajtim me këtë Ligj.

Ushtrimi i të punësuarve

Neni 42

Për aplikimin efikas të këtij Ligji, organi i shtetit e zbaton ushtrimin e të punësuarve dhe njohjen e të punësuarve me obligimet e veta lidhur me të drejtat e rregulluara me këtë Ligj.

Ushtrimi i të punësuarve nga paragrafi 1, i këtij neni, do t'i përfshijë sidomos: përmbajtjen, vëllimin dhe rëndësinë e të drejtave për qasje informatave me rëndësi publike, procedurën e realizimit të këtyre të drejtave, procedimin me bartësit e informatave, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre si dhe llojet e të dhënave që organi i shtetit ka për detyrë t'i publikojë.

Paraqitja e raportit Komisarit

Neni 43

Personi i autorizuar i organit të shtetit ia paraqet raportin vjetor Komisarit mbi veprimet e këtij organi, të marra me qëllim të aplikimit të këtij Ligji, i cili i mban të dhënat mbi:

- 1) numrin e kërkesave të paraqitura, numrin e kërkesave të miratuara plotësisht ose pjesërisht si dhe mbi numrin e kërkesave të pashqyrta ose të refuzuara;
- 2) numrin dhe përmbajtjen e ankesave kundër aktvendimeve me të cilat nuk shqyrtohet ose refuzohet kërkesa;
- 3) shumën e përgjithshme të kompensimeve të paguara mbi realizimin e të drejtës për qasje informatave me rëndësi publike;
- 4) masat e marra lidhur me obligimin e botimit të informatorit;
- 5) masat e marra lidhur me mirëmbajtjen e bartësit të informatës;
- 6) masat e marra për stërvitjen e të punësuarve.

VII. KOMPENSIMI I DËMIT

Neni 44

Organi i pushtetit përgjigjet për dëmin e shkaktuar me atë që mjete publik nuk ka mundur ta botojë informatën pasi që pa arsye ia ka kufizuar ose penguar të drejtën për qasje informatave me rëndësi publike nga neni 5 i këtij Ligji, respektivisht me atë që gazetari apo mjete publik është vënë në pozitë më të mirë në kundërshtim me dispozitën e nenit 7, të këtij Ligji.

VIII. MBIKËQYRJA

Neni 45

Mbikëqyrjen e zbatimin e këtij Ligji e bën ministria kompetente për punët e informimit.

IX. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 46

Me dënim me të holla prej 5.000 deri 50.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje personi i autorizuar në organin e pushtetit në qoftë se organi i pushtetit:

- 1) procedon kundër parimit të barazisë (neni 6);
- 2) e diskriminon gazetarin apo mjetin publik (neni 7);
- 4) nuk e shënon bartësin e informatës, ku dhe është botuar informata e kërkuar (neni 10. Parag. 2);
- 5) nuk e kumton të vërtetën dhe informatën e plotë, respektivisht nuk e mundëson shikimin në dokumentin i cili e përmban informatën e vërtetë e të plotë (neni 11);
- 6) kërkuesit nuk ia jep në shikim dokumentin dhe nuk e punon kopjen e dokumentit në gjuhën në të cilën është paraqitur kërkesa (neni 18. Parag. 4);
- 7) refuzon ta pranojë kërkesën, nuk e njofton kërkuesin për disponimin e informatës ose nuk siguron shikimin në dokumentin i cili e përmban informatën e kërkuar, respektivisht nuk ia dërgon kopjen e dokumentit në mënyrë adekuate, nuk merr aktvendimin për refuzimin e kërkesës dhe e refuzon t'u ofrojë kërkuesve ndihmën e domosdoshme për realizimin e të drejtave të tyre (neni 38. parag. 2. pika 1).

Neni 47

Me dënim me të holla, prej 5.000 deri 50.000 dinarë, do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në organin e shtetit në qoftë se organi i shtetit e lë pa e punuar informatorin me të dhënat e normuara mbi punën e vet (neni 39).

Neni 48

Me dënim me të holla, prej 5.000 deri 50.000 dinarë, do të dënohet për kundërvajtje personi i autorizuar në organin e shtetit nëse e lë pa ia paraqitur raportin vjetor Komisarit mbi veprimet e atij organi, të marra me qëllim të aplikimit të këtij Ligji, me të dhëna të normuara (neni 43)

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 49

Organi i pushtetit do ta emërojë personin e autorizuar për të vendosur mbi kërkesat për qasje të lirë informatave me rëndësi publike, në afatin prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji
Kuvendi Popullor do ta zgjedh Komisararin, në afatin prej 45 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.

Neni 50

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në «Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë».

Shtojca 2

**SHEMBUJT E FORMULARËVE
PËR USHTRIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE
DHE PARAQITJA SKEMATIKE PROCEDURËS**

emri dhe selia e organit
të cilit i drejtohet kërkesa

KËRKESË PËR QASJE INFORMATËS ME RËNDËSI PUBLIKE

Në pajtim me nenin 15, parag. 1, të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike (“Fletorja Zyrtare e RS” nr. 120/04), nga organi i lartpërmendur kërkoj*:

- njoftim nëse e disponon informatën e kërkuar;
- shikimin e dokumentit, i cili e përmban informatën e kërkuar;
- kopjen e dokumentit që e përmban informatën e kërkuar;
- dorëzimin e kopjes së dokumentit i cili e përmban informatën e kërkuar * :
me postë me postë elektronike faks mënyrë tjetër

_____.**

Kjo kërkesë ka të bëjë me këto informata:

(ceke sa më saktë përshkrimin e informatës që kërkohet si dhe të dhënat e tjera të cilat e lehtësojnë gjetjen e informatës së kërkuar)

Në _____, më ____ 200__

Kërkuesi i informatës

nënshkrimi

emri e mbiemri

adresa

të dhënat tjera për kërkuesin

* Në shtëpizë shenone mënyrën e dërgimit të kopjes së dokumentit.

** Kur kërkoni mënyrë tjetër të dërgimit, patjetër shenone se në çfarë mënyrë duhet të bëhet dërgimi.

SHEMBULLI I NJOFTIMIT PËR SIGURIMIN E QASJES INFORMATAVE

(emri dhe selia e organit)

Numër: _____

Datë: _____

Në pajtim me nenin 16, parag. 1 dhe 5, të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike, duke proceduar sipas kërkesës (**emri dhe mbiemri i ushtruesit të kërkesës**) për shikim në dokumentin, i cili e përmban (**përshkrimi i informatës së kërkuar**), ua dorëzoj:

N J O F T I M I N

mbi vënien në shikim të dokumentit që e përmban informatën e kërkuar dhe mbi punimin e kopjes

Duke proceduar sipas kërkesës numër ____ të cilën e ka ushtruar (**emri dhe mbiemri i kërkuesit të informatës**), në afatin e përcaktuar me nenin 16. parag 1. të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike, Ju njoftojmë se më datë _____, në kohën _____, në lokalet e organit, mund ta bëni shikimin e dokumentit ku gjendet informata e kërkuar të cilën e keni cekur në kërkesë.

Me atë rast, me kërkesën Tuaj, do T'u lëshohet edhe kopja e dokumentit me informatën e kërkuar

Kopja për një faqe të formatit A4 është _____ dinarë.

Shuma e shpenzimeve të përgjithshme për punimin e kopjes së dokumentit të kërkuar është _____ dinarë, dhe paguhet në xhiro-llogarinë _____.

Dorëzuar:

1. të emëruarit
2. arkivit

(V..V)

(nënshkrimi i personit të autorizuar
përkatësisht i drejtuesit të organit)

SHEMBULLI I ANKESËS KUNDËR AKTVENDIMIT MBI REFUZIMIN PËR QASJE INFORMATËS

(emri dhe selia e organit të shkallës së parë)

për

Komisarin për informata me rëndësi publike

(selia e Komisarit)

Lënda:

A N K E S Ë*

(emri, mbiemri, respektivisht emri, adresa dhe selia e ankuesit) kundër aktvendimit (emri i organit që e ka marrë aktvendimin) numri _____ prej _____ vit, në ___ kopje.

Aktvendimin e cekur e refuzoj në tërësi, sepse nuk mbështetet në Ligjin mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike.

Me diapozitivin e aktvendimit të cekur, në kundërshtim me nenin ____* të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike, kërkesa ime është refuzuar pa bazë. Prandaj konsideroj se organi me aktvendimin për refuzimin e kërkesës ma ka kufizuar të drejtën kushtetuese e ligjore për qasje informatave+ me rëndësi publike.

Në bazë të arsyeve të paraqitura, propozoj që ankesa të merret parasysh, dhe të anulohet aktvendimi i organit të shkallës së parë, dhe të mundësohet qasje informtës së kërkuar.

Ankesën e ushtroj me kohë, në afatin ligjor të përcaktuar në nenin 22. Parag. 1, të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike.

Në Beograd, më _____ 200__.

Parashtruesi i ankesës

(nënshkrimi)

emri e mbiemri

adresa

SHËMBULLI I ANKESËS KUR NUK ËSHTË VENDOSUR

Vërejtje: Në ankesë duhet cekur aktvendimin i cili refuzohet, emri i organit që e ka marrë, si dhe numri e data e aktvendimit. Mjafton që ankuesi ta paraqes në ankesë se në çfarë pikëpamje është i pakënaqur me aktvendimin, dhe në ankesë nuk ka nevojë ta arsyetojë në veçanti. Në këtë formular është dhënë vetëm njëri nga versionet e mundshëm të arsyetimit të ankuesit, kur organi i shkallës së parë e ka marrë aktvendimin për refuzimin e kërkesës për qasje informatave.

* Vërrejtje: Të ceket neni i Ligjit të cilin e ka shkelur organi i pushtetit për shkurtimin e qasjes informatave. Fjala është, më shpesh, për dispozitat që i përmbajnë nenët 8-14, të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike, që kanë të bëjnë me përjashtimin dhe kufizimin e të drejtave për qasje informatave.

SIPAS KËRKESËS (HESHTJA E ADMINISTRATËS)

(emri i selisë së organit të shkallës së parë)

për

Komisarin për informata me rëndësi publike

(selia e Komisarit)

Në pajtim me nenin 22, të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike parashtroj:

A N K E S Ë N

për shkak të mosprocedimit të organit (**emri i organit**) sipas kërkesës për qasje informatave me rëndësi publike në afatin e normuar ligjor.

Më datë _____, ia kam parashtruar (**emri i organit të cilit i është parashtruar kërkesa**) kërkesën për qasje informatave me rëndësi publike, ku nga organi kompetent kam kërkuar (**ceki të dhënat mbi kërkesën dhe informatën**).

Ankesës ia bashkangjes vërtetimin mbi kërkesën e parashtruar (kopjen e kërkesës)

Pasi që nga parashtrimi i ankesës ka kaluar afati i normuar me ligj në të cilin organi i pushtetit ka pasur për detyrë të procedojë ndaj kërkesës në pajtim me nenin 16. parag. 1. e 3, të Ligjit, janë krijuar kushtet për parashtrim ankesë Komisarit.

Në Beograd, më _____ 200__ .

Parashtruesi i ankesës,

nënshkrimi

emri e mbiemri

adresa

Shtojca 3

LISTA DHE ADRESAT
e organeve më të rëndësishme të
pushtetit publik në Republikën e Serbisë

ORGANET MË TË LARTA TË SHETIT

Presidenti i Republikës së Srbisë – Andriqev venac 1, 11000 Beograd
Kuvendi Popullor i Republikës së Srbisë - Kralja Milana 14
Qeveria e Republikës së Serbisë – Nemanjina 11
Gjykata e Lartë e Serbisë – Resavska 42
Gjykata Kushtetuese e Serbisë – Nemanjina 26
Prokuroria Publike Republikane - Nemanjina 24

MINISTRITË

Ministria e Punëve të Brendshme – Kneza Milosha 101, 11000 Beograd
Ministria e Financave – Nemanjina 22-26
Ministria e Drejtësisë – Nemanjina 22-26
Ministria për Administratën e Shtetit dhe Vetëqeverisjen Lokale – Birçaninova 6
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave – Nemanjina 22-26
Ministria e Ekonomisë – Oralja Milna 16
Ministria e Xehetarisë dhe Energjetikës – Oralja Milana 36
Ministria për Investime Kapitale – Nemanjina 22-26
Ministria e Tregtisë, Turizmit dhe Shërbimeve – Nemanjina 22-26
Ministria për Marrëdhënie Ekonomike me Jashtë - Graçaniçka 8
Ministria e Punës, Punësimit dhe e Politikës Sociale – Nemanjina 22-26
Ministria e Shkencës dhe e Mbrojtjes së Ambientit – Nemanjina 22-26
Ministria e Arsimit dhe e Sportit – Nemanjina 22-26
Ministria e Kulturës – Vlajkoviçeva 3
Ministria e Shëndetësisë – Nemanjina 22-26
Ministria e Feve – Nushiçeva 4
Ministria për Diasporën – Vase Çarapiça 20

GJYKATAT

Gjykata e Qarkut në Beograd – Savska 17a, 11000 Beograd
Gjykata e Parë Komunale në Beograd – Savska 17a
Gjykata e Dytë Komunale në Beograd – Savska 17a
Gjykata e Tretë Komunale në Beograd – Timoçka 15
Gjykata e Katërt Komunale në Beograd – Bulevar Mihajla Pupina 10
Gjykata e Pestë Komunale në Beograd – Ustaniçka 14
Gjykata Komunale në Obernovac – Bore Qiriça bb, Obrenovc
Gjykata Komunale në Llazarevac – Karagjorgjeva 19, Lazarevc
Gjykata Komunale në Sopot – Kosmajka 3, Sopot
Gjykata Komunale në Mlladenovac – Milosava Vlajiça 76, Mladenovc
Gjykata e Qatrkut në Valevë – Karagjorgjeva 48, Valevë
Gjykata e Qarkut në Vranjë – Trg Republike 1, Vranjë
Gjykata e Qarkut në Gjilan – Gjykata e Qarktu në Vranjë
Gjykata e Qarkut në Zajëçar –Generala Gambete bb, Zajëçar
Gjykata e Qarkut në Zrenjanin –Kej Drugog oktobra 1, Zrenjanin
Gjykata e Qarkut në Jagodinë – Knjeginje Milice 86, Jagodinë
Gjykata e Qarkut në Mitrovicë – Gjykata e Qarktu në Krlevë
Gjykata e Qarkut në Kragujevac – Trg Vojvode Radomira Putnika 4, Kragujevc
Gjykata e Qarkut në Krlevë – Karagjorgjeva 5, Krlevë
Gjykata e Qarkut në Krushevac – Trg Kosovskih junaka 3, Krushevc
Gjykata e Qarkut në Leskovac – Pana Gjukiça 27, Leskovc
Gjykata e Qarkut në Negotin – Trg Stevana Mokranjca 1, Negotin
Gjykata e Qarkut në Nish – Vozhdova 23, Nish

Gjykata e Qarkut në Novi Pazar – Zhitni trg 16, Novi Pazar
Gjykata e Qarkut në Novi Sad – Sutjeska 3, Novi Sad
Gjykata e Qarkut në Pançevë – Vojvode Putnika 13-15, Pançevë
Gjykata e Qarkut në Pejë – Gjykata e Qarkut në Leskovac
Gjykata e Qarkut në Pirot – Srpskih vladara 126a, Pirot
Gjykata e Qarkut në Pozharevac – Jova Sherbanoviqa 4, Pozharevac
Gjykata e Qarkut në Prizren – Gjykata e Qarkut në Pozharevc
Gjykata e Qarkut në Prishtinë – Gjykata e Qarkut në Nish
Gjykata e Qarkut në Prokupje – Tatkova 1, Prokuple
Gjykata e Qarkut në Smederevë – Trg Republike 2, Smederevë
Gjykata e Qarkut në Sombor – Stepe Stepanoviqa bb, Sombor
Gjykata e Qarkut në Sremska Mitrovicë – Trg Svetog Dimitrija 39, S. Mitrovica
Gjykata e Qarkut në Suboticë – Senqanski put 1, Suboticë
Gjykata e Qarkut në Uzhicë – Nade Matiq 6, Uzhicë
Gjykata e Qarkut në Çaçak – Cara Dushana 6, Çaçak
Gjykata e Qarkut në Shabac - Gospodar Jevremova 8, Shabac

Gjykata e Lartë e Tregtisë në Beogradu – Nemanjina 22-26, Beograd
Gjykata e Tregtisë në Beogradu – Masarikova 2, Beograd
Gjykata e Tregtisë në Nish – Svetosavska 7e, Nish
Gjykata e Tregtisë në Kragujevc – Trg AVNOJ-a, Kragujevc
Gjykata e Tregtisë në Pozharevc – Jovana Sharbanoviqa 4, Pozharevc
Gjykata e Tregtisë në Uzhicë – Nade Matiq 6, Uzhicë
Gjykata e Tregtisë në Zajeçar – Trg oslobogjenja 30, Zajeçar
Gjykata e Tregtisë në Kralevë – Cara Dushana 41, Kralevë
Gjykata e Tregtisë në Valevë – Karagjorgjeva 43a, Valevë
Gjykata e Tregtisë në Leskovac – Blagoja Nikoliqa 1, Leskovc
Gjykata e Tregtisë në Novi Sad – Sutjeska 3, Novi Sad
Gjykata e Tregtisë në Sombor – Zhivojina Mishiqa 23, Sombor
Gjykata e Tregtisë në Suboticë – Maresov lug 1, Suboticë
Gjykata e Tregtisë në Sremska Mitrovicë – Svetog Dimitrija 39, S. Mitrovicë
Gjykata e Tregtisë në Pançevë – JNA 13, Pançevë
Gjykata e Tregtisë në Zrenjanin – Kej 2. oktobra 1, Zrenjanin
Gjykata e Tregtisë në Çaçku – Cara Dushana 6, Çaçak

ORGANIZAT E POSAÇME

Enti Republikan i Gjeodezisë - Bulevar Vojvode Mishiqa 39
Enti Republikan Hidrometeorologjik i Serbisë - Kneza Vishaslava bb
Enti Republikan për Statistikë - Milana Rakiaq 5
Drejtoria Republikane për Rrugët - Autoput za Nish, bb
Drejtoria Republikane për Pronën e Republikës së Serbisë – Graçanička 8
Agjencioni për Reciklzhë i Republikës së Serbisë – Masarikova 5
Republika e Srbisë- Agjencioni për investime të huaja dhe promovimin e eksportit– Terazije 23
Komesariati për Refugjatë – Carice Milice 2
Republika e Srbisë – Drejtorati për Furnizime Publike - Kneza Milosha 20
Enti Seizmologjik i Serbisë - Tashmajdan Park bb.
Enti Republikan për Zhvillim – Makedonska 4
Sekretariati Republikan për Legjislacion - Nemanjina 11
BIA - Kralice Ane bb
Enti Republikan për Informatikë e Internet - Deçanska 8a
Agjencia për zhvillimin e infrastrukturës së vetëqeverisjes lokale - Omladinskih brigada 1, SIV 3
Qendra për Çminim - Vojvode Toze 31

NDËRMARRJET PUBLIKE

Enti për tekste dhe mjete mësimore – Milorada Jovanoviça 11, 11000 Beograd
NP “Parku Kombëtar Kopaonik”, Sunçani Vrhovi bb, 36000 Kopaonik
NP “Parku Kombëtar Gjerdap”, Krala Petra I 14a, 19220 Donji Milanovac
NP “Parku Kombëtar Frushka Gora”, Zmajev trg 1, 11000 Beograd
NP “Parku Kombëtar Tara”, Milenka Topaloviça 3, 31250 Bajina Bashta
NP “Ndërmarrja publike për strehimoret”, Braniçevska 3, 11000 Beograd
NP “Industria e Naftës e Serbisë”, Narodnog fronta 12, 21000 Novi Sad
NP “Srbija shuma”, Bulevar Muhajla Pupina 113, 11070 Novi Beograd
NP “ZHTP Beograd” Nemanjina 6, 11000 Beograd
NP “Aerodrom”, Aerodrom Beograd, 11000 Beograd
NP “PTT trafiku”, Takovska 2, 11000 Beograd
NP “Elektroekonomia e Serbisë”, Balkanska 13, 11000 Beograd
NP “JAT Airways”, Bulevar umetnosti 16, 11070 Beograd
NP “Radio- televizioni i Serbisë”, Takovska 10, 11000 Beograd
NP “Serbia voda”, Bulevar umetnosti 2, 11070 Novi Beograd
NP “Fletorja Zyrtare e RS”, Oralja Milutina 27, 11000 Beograd
NP “Panorama” Prishtinë – Beograd, Krunska 44, 11000 Beograd

Republika e Serbisë

Komisari për informata me rëndësi publike

Me miratimin e Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike, në fillim të nëntorit të vitit 2004, Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë ka bërë një hap të rëndësishëm në avancimin e sistemit tonë juridik. Me këtë jo vetëm që është absolutuar njëri nga kushtet formale për anëtarësim që Këshilli i Evropës e ka parashikuar për anëtarët e vet, por janë siguruar parakushtet qenësore normative që edhe tek ne të mbrohet e drejta e qytetarit që në mënyrë efikase ta kontrollojë punën e aparatit të shtetit. Edhe krahas faktit që Ligji i ri në masë të madhe korrespondon me standardet juridike që janë afirmuar dhe përqaftuar në kuadrin e vendeve që janë anëtare të Këshillit të Evropës, ai përmban edhe dispozitat me vlerësimin e të cilave duhet pritur. Dilemat lidhur me disa zgjidhje kundërtëse nga Ligji do t’i zgjidh gjyqtari më i mirë, praktika

Praktika, zbatimi i Ligjit në botën reale e jo në atë normative, do ta japë vlerësimin jo vetëm për cilësinë e disa normave dhe të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike, por edhe për diç më të rëndësishme, mbi sinqeritetin, vullnetin dhe aftësinë e shtetit të sigurojë që të drejtat e qytetarit, përpos në faqet e Fletorës Zyrtare, të ekzistojnë edhe atje ku e kanë vendin e duhur, në jetën reale

Kjo, kuptohet, nuk do të shkojë as shpejt as lehtë. Të drejtat e reja të qytetarëve i sjellin në pikëpyetje interesat e ndryshme të individëve ose grupeve, interesat e të cilave nuk janë legjitime në shoqërinë demokratike. Të drejtat e reja presupozojnë edhe obligime të reja për burokracinë e cila, natyrisht, këtë e pranon pa andje. Të drejtat e reja janë në konflikt të përgjithshëm me inercionin e shoqërive konservatore, me tradicionalizmin, me atmosferën shoqërore në të cilën monopoli mbi informatat, të “fshehta” e mistifikuese, janë leva të rëndësishme të kontrollit të proceseve shoqërore.

Njërën nga pengesat më të mëdha për zbatimin e ligjit të ri e paraqet mosdija. Me fjalë tjera, është evidente se të paktën për momentin, as qytetarët as mediat nuk janë në masë të duhur të njohura as me përmbajtjen e të drejtave të reja, as me mënyrën e realizimit të tyre. Kjo gjendje

duhet të ndryshohet. Vetëm në qoftë se qytetarët dhe mediat mësojnë se kanë fituar një mjet të ri cilësor për realizimin e interesave të veta, dhe atë si të atyre ditore, ekzistenciale ashtu edhe të atyre të abstrahuara me anë të nevojës që të jetohet në ambientin demokratik, Ligji do ta ruaj kuptimin.

Për këtë shkak nuk është e rastit që Ligji, si një nga detyrat prioritare të Komisarit për informata me rëndësi publike, ka parashikuar obligimin e botimit të doracakut përkatës. Fjala është për tekstin i cili në një mënyrë të thjeshtë, direkte e të qartë do t'i njihet qytetarët me përmbajtjen e të drejtave të cilat i garanton Ligji, e veçmas me mënyrën që ato të drejta të realizohen sa më lehtë.

Kur Kuvendi Popullor më zgjodhi kah fundi i dhjetorit të vitit 2004, Komisar të parë për informata em rëndësi publike u përballa jo me një, veç me një numër të madh të detyrave të cilat meritojnë atributin e prioritetit. Megjithatë, nevoja e hartimit të doracakut për aplikimin e Ligjit dhe nevoja e zbatimit të fushatës përkatëse, madje sikur kjo edhe të mos ishte e parashikuar me Ligj, për mua kanë paraqitur njërin nga prioritetet kryesore.

Fatkeqësisht, pas zgjedhjes u përballa edhe me qëndrimin krejtë joadekuat të përgjegjësve ndaj problemeve në zbatimin e Ligjit. Ashtu ndodhi që as 4 muaj pas miratimit të Ligjit, Komisarit të zgjedhur nuk i janë siguruar as kushtet më elementare për punë. As hapësira, as pajisja, as bashkëpunëtorët. Një situatë e tillë, natyrisht, tek unë ka shkaktuar brengosje, veçmas në raport me realizimin e një detyre aq komplekse çfarë është punimi i doracakut, i cili me përmbajtje cilësore presupozon edhe përkthimin në gjuhët në përdorim zyrtar, shtypin me tirazh të madh, shpërndarjen.

Ndihma mbërriti nga pala e pritur, nga sektori civil, grupi i organizatave joqeveritare, të tubuara në Koalicionin për lirinë e qasjes informatave, i cili edhe deri më tash ka dhënë një kontribut të madh në afirmimin e ideve të përmabjtura në Ligjin mbi qasjen e lirë informatave dhe në miratimin e vet Ligjit, ka vazhduar të japë kontribut edhe në zbatimin e tij. Ekipi i ekspertëve e ka përgatitur doracakun me emër "Udhërrëfyesi për Ligjin mbi qasjen e lirë informatave". Projektin e hartimit të Udhërrëfyesit i ka mbështetur edhe Misioni i OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi. Projekti ka rezultuar me tekstin i cili me përmbajtjen e vet dhe me mënyrën e prezantimit të tij, është orientuar kah rrethi më i gjërë i mundshëm i shfrytëzuesve, dhe atë sipas mënyrës e cila është e përshtatshme që zgjidhjet nga Ligji t'i bëjë të kuptueshme dhe më të qarta, e vetvetiu që realizimin e të drejtave të shfrytëzuesve potencial ta bëjë më të thjeshtë.

Si dikush që është përgjegjës për aplikimin e Ligjit të ri, i falenderohem edhe Koalicionit për lirinë e informimit edhe Misionit të OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi. Besoj se bashkëpunimin do ta vazhdojmë dhe ai në të ardhmen do të japë rezultate të mira.

Udhërrëfyesi për Ligjin mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike pa dyshim se është tekst i shkruar mirë. Megjithatë, do t'i shërbejë qëllimit të vet vetëm në qoftë se cilësitë e veta ia nënshtron aplikimit praktik. Besoj se do të jetë ashtu. Udhërrëfyesi jo vetëm se mund t'ua lehtësojë qytetarëve dhe mediave realizimin e të drejtave të garantuara me ligj, veç mund edhe organeve të pushtetit t'u ndohmojë në kryerjen e obligimeve. Nëse do të jetë ashtu, do të kontribuojë që në rrugën e gjatë të transformimit të shoqërisë tonë në shoqëri demokratike, të hapur, të paktën një hap të jetë më i sigurt dhe më i fortë.

Beograd, 21 Shkurt 2005.

Komisari,

Rodoljub Shabiq

Shtojca 4

Mbi koalicionin për qasje të lirë informatave

Udhërrëfyesi që është para jush ka lindur në kuadrin e ekipit të ekspertëve të Koalicionit për qasje të lirë informatave.¹ Koalicioni është krijuar nga nevoja që me aksion të bashkuar të shoqërisë civile dhe të qytetarëve si individë, të ndikohet në pushtetin në Serbi - Qeverinë dhe Kuvendin Popullor, që sa më parë ta nxjerrin Ligjin mbi qasjen e lirë informatave. Koalicionin e përbën bërthama iniziale e disa organizatave joqeveritare nga Beogradi, të cilat me punën e vet të deritashme janë dalluar në fushën e mbrojtjes dhe promovimin e të drejtave të njeriut, dhe atë: Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Aksionin Antiluftë, Qendra për Përparimin e Studimeve Juridike, Fondi për Shoqërinë e Hapur (bashkërenduesi), Iniciativat Qytetare, Komiteti i Juristëve për të Drejtat e Njeriut - Yukom, Transparenca Serbia. Anëtarët e Koalicionit kanë dhënë kontribut për nxjerrjen e Ligjit, i cili çdo individ në Serbi do t'ia garantojë qasjen e lirë informatave në disponim të organit të pushtetit.

Është punuar edhe në atë që teksti ligjor të avancohet maksimalisht në mënyrë që të jetë më efikas në praktikë. Në këtë nuk i është dalë në tërësi. Ligji, sipas mendimit tonë ka pika të dobëta, kurse praktika do të jetë gjyqtari më i mirë.

Koalicioni e vazhdon punën e vet e cila do të jenë veçanërisht e rëndësishme në procesin e aplikimit të Ligjit. Të vetëdijshëm se institucionet tona të pushtetit ende nuk kanë profil dhe kapacitet të nevojshëm demokratik, e duke pasur parasysh përvojat e vendeve tjera të cilat, si edhe vendi ynë, me dekada e kanë kultivuar kulturën e fshetësisë, jemi të bindur se sfida e mirëfilltë, kur është fjala për këtë Ligj, do të jetë pikërisht aplikimi i tij. Me fjalë të tjera, demokratizimi i institucioneve, transparenca e tyre ndaj qytetarëve, mundësia e qytetarëve për ta kontrolluar punën e organeve të pushtetit, të bartësve të funksioneve dhe të nëpunësve publikë, do të jetë proces i gjatë i pushtimit të lirisë. Koalicioni ka për qëllim që në këtë proces t'u ndihmojë qytetarëve.

Njëri nga hapat e parë, përpos hartimit të Udhërrëfyesit, është shtrirja e Koalicionit. Atë tani e përbëjnë edhe 6 anëtarë të rinj, dhe atë: Shoqata e Qytetarëve "Sretenej" nga Pozhega; Këshilli Qytetar i Komunës së Krlevës; Forumi Iuris, Novi Sad; Qendra për Edukim Civil, Vrshac; Resurs Qendra, Negotin; Qendra

¹ Ekipin e ekspertëve të Koalicionit e kanë përbërë: Vladimir Vodinelij, Sasha Gajin dhe Tanasije Marinković (Qendra për Avancimin e Studimeve Juridike), Dejan Milenković (Komiteti i Juristëve për të Drejtat e Njeriut - Yukom), Nemanja Nenadić (Transparenca Serbia), Tamara Lukshiq – Orlandiq (Fondi për Shoqëri të Hapur), Svetislava Bulajiq (Misioni i OSBE në SCG). Në punën e ekipit, kohë pas kohe, kanë marrë pjesë edhe: Milenko Dereta (Iniciativat Qytetare), Angjellka Marković e Igor Bandović (Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut) dhe Aleksandar Resanović (Qendra për Aksionin Anti-luftarak).

e Toplicës për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, Prokuple. Me anë të fushatës së menduar mirë dhe me aktivitete të tjera, para së gjithash në shkallë lokale, Ligji do të testohet në praktikë. Do të përcillet fati i kërkesave të parashtruara për qasje informatave dhe do të ndihmohen qytetarët që këtë të drejtë të tyre para organeve të pushtetit ta realizojnë më lehtë. Pas një viti të përcjelljes së zbatimit të Ligjit, Koalicioni do të ketë mundësi ta hartojë raportin e parë dhe t'ia ofrojë opinionit për vlerësim.

Koalicioni në kuadër të projektit të Fondit për Shoqëri të Hapur, në bashkëpunim me partnerët e interesuar ndërkombëtar - Organizatën për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE), Këshillin e Evropës, Institutin për Shoqëri të Hapur, Article 19, dhe me aktorë të tjerë me përvojë në këtë fushë, të jeshë partner i pushtetit dhe i Komisarit për informata me rëndësi publike, si institucion i pavarur, në aktivitete të shumta, para së gjithash, edukative dhe në trajnimin e nëpunësve publikë, përfaqësuesit e mediave dhe të OJQ, për aplikimin sa më konsekuent dhe sa më të plotë të Ligjit mbi qasjen e lirë informatave me rëndësi publike, në praktikë.

Me këtë rast, Koalicioni i falënderohet Misionit të OSBE-së në SMZ, në mirëkuptimin për ta mbështetur hartimin e Udhërrëfyesit. E ndajmë bindjen e Misionit të OSBE-së se duhet dhënë stimul shtojcë gazetarëve, përfaqësuesve të OJQ-ve dhe qytetarëve që të drejtën e vet për qasje të lirë informatave në disponim të pushtetit publik ta realizojnë sa më lehtë në praktikë.

Ekipi i ekspertëve
Koalicioni për qasjen e lirë informimit

Beograd, Shkurt 2005.